

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA  
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË  
KOSOVËS

# RAPORTI I VITIT 2023



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA  
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË  
KOSOVËS**

# **RAPORTI I VITIT 2023**



**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**

# Përmbajtja

<b>DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS</b>	<b>04</b>
Parathënie	06
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	08
<b>DHOMAT</b>	<b>20</b>
1. Aktivitetet Gjyqësore	21
2. Aktivitetet e Kryetares dhe Gjykatësve	32
3. Aktivitetet e jashtme	34
<b>MARRËDHËNIET ME JASHTË</b>	<b>36</b>
<b>ZYRA ADMINISTRATIVE</b>	<b>40</b>
1. Kabineti i Administratores	42
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	44
2.1 Marrëdhëniet me mediat	45
2.2 Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim	46
2.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjetin e Informimit të Gjykatës	47
2.4 DHSK-ja në internet	48
3. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	50
4. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	52
4.1 Njësia e Administrimit të Gjykatës	52
4.2 Njësia e Përkthimit	53

4.3	Zyra e Mbrojtjes	54
4.4	Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	55
4.5	Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	56
4.6	Njësia e Paraburgimit	57
<b>5.</b>	<b>Seksioni i Administratës</b>	<b>58</b>
5.1	Njësia e Burimeve Njerëzore	59
5.2	Njësia e Teknologjisë së Informacionit	62
5.3	Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	63
5.4	Njësia e Sigurisë	63
5.5	Njësia e Financave dhe Buxhetit	64
5.6	Njësia e Prokurimit	65
<b>6.</b>	<b>Zyra e Auditimit</b>	<b>66</b>
	<b>INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS</b>	<b>68</b>
1.	Nxitja e një mjedisi pune mbështetës dhe gjithëpërfshirës në DHSK dhe ZPS	69
2.	Personi i kontaktit për çështje gjinore	73
	<b>ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR</b>	<b>76</b>
	Parathënie	78
	Hetimet e ZPS-së	79
	Zbatimi i mandatit	80
	Kuadri udhëheqës i Prokurorisë	86
	Ekipe të Prokurorisë	89



# DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

# Parathënie

Është kënaqësi për ne t'ju paraqesim raportin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) për vitin 2023. DHSK-ja ka vazhduar të përmbushë mandatin në mënyrë efikase dhe efektive. Gjatë këtij viti u arritën një gamë e gjerë objektivash të rëndësishme me lëshimin e aktgjykimit të parë të apelit të DHSK-së - për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë - dy vendimeve të para mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit si rezultat i këtij aktgjykimi të apelit dhe aktgjykimit të parë të apelit në lidhje me krime lufte. Kanë filluar dhe kanë përparuar në mënyrë efikase dy procese gjyqësore. Gjithashtu, në Kosovë janë arrestuar katër persona të akuzuar për frikësim të dëshmitarëve. Një person me banim në Shqipëri është akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, por nuk është transferuar ende në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Ritmi i shpejtë me të cilin vazhdon të përparojë DHSK-ja vjen nga përkushtimi i palëkundur i gjykatësve të DHSK-së, anëtarëve të personelit dhe punonjësve të tjerë të gjithë gjykatës.

Veprimtaritë gjyqësore të DHSK-së u intensifikuan edhe më tej gjatë vitit 2023. Konkretisht, dy çështje gjyqësore filluan me deklaratat hyrëse dhe vazhduan me paraqitjen e provave. Në një nga këto çështje, faza e paraqitjes së provave pothuajse ka përfunduar. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet u lëshua aktgjykimi i parë për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Në të njëjtën çështje, Kryetarja dha edhe vendimin e parë mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimeve pasi dy personat e dënuar kishin vuajtur dy të tretat e dënimit. Gjithashtu u shpall edhe aktgjykimi i parë i apelit në lidhje me krime lufte. Gjatë të njëjtës periudhë, në Kosovë u arrestuan katër persona dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së, ndërsa filloi procedura paraprake për dy nga këto çështje. Po ashtu, një person me banim në Shqipëri është akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Megjithëse gjykatat shqiptare fillimisht ndihmuan në arrestimin e tij në korrik 2023, deri në fund të vitit gjykatat shqiptare nuk e kishin miratuar ende kërkesën e DHSK-së për transferimin e tij në Hagë.

Për herë të parë që kur DHSK-ja u bë funksionale në aspektin gjyqësor, trupat gjykues në të gjitha nivelet e procesit shqyrtuan aspekte të ndryshme, konkretisht, Gjykatësi i Vetëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Trupat Gjykues, Panelet e Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Supreme, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarja.

Në vitin 2023, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e tyre vjetore gjatë të cilës gjykatësit u përditësuan mbi aspekte të rëndësishme institucionale dhe u përfshinë në diskutimin e temave të ndryshme të agjendës së seancës plenare. Gjykatësit u takuan përsëri në shtator për një seminar, në të cilin bashkëbiseduan me të ftuar të ndryshëm për tema të rëndësishme të së drejtës penale ndërkombëtare.

Bashkëpunimi dypalësh me shtetet ka rëndësi jetike për aftësinë e DHSK-së që të përmbushë mandatin e vet. Përgjatë vitit 2023, kemi vazhduar të theksojmë në të gjithë takimet diplomatike rëndësinë e finalizimit të marrëveshjeve për zbatimin e dënimeve për personat e dënuar nga DHSK-ja.

Në korrik dhe në tetor shkuam në Nju Jork ku morëm pjesë në veprimtari të organizuara nga bashkësia ndërkombëtare mbi tema të ndryshme të së drejtës penale dhe informuam anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare për mandatin dhe punën e gjykatës. Në nëntor, Kryetarja vizitoi Kosovën për t'u takuar me shoqërinë civile, me mediat e të tjerë për t'i informuar rreth proceseve aktuale dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me DHSK-në dhe mandatin e saj.

Ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit ka vazhduar të organizojë një gamë të gjerë veprimtarish me anëtarë të shoqërisë civile në Kosovë. Gjithashtu, në prill DHSK-ja priti në ambientet e saj Rrjetin e Informimit të Gjykatës (RRIGJ) për një punëtori ku u dhamë informacion anëtarëve të RRIGJ-it dhe morëm prej tyre komente shumë të vlefshme për përmbajtjen dhe efikasitetin e programit të komunikimit dhe ndërgjegjësimit. DHSK-ja ka qenë në gjendje ta zhvillojë programin e vet rigoroz të komunikimit dhe ndërgjegjësimit falë kontributit financiar zemërgjerë të Zvicrës.



---

Puna për komunikim dhe ndërgjegjësim po bëhet edhe në media sociale. Proceset gjyqësore të DHSK-së mund të ndiqen ose përmes transmetimit të drejtpërdrejtë në faqen e saj të internetit ose përmes kanalit të saj në YouTube. Gjithashtu, përditësimet më të rëndësishme pasqyrohen në faqen e rrjetit të DHSK-së, në funksionin “LiveUpdate” (Përditësim i drejtpërdrejtë), si edhe në llogarinë në X të DHSK-së. Anëtarët e Njësisë së Informacionit dhe Komunikimit me Publikun të DHSK-së janë gjithmonë të gatshëm t’i përgjigjen të gjitha pyetjeve që iu bëhen si nga përfaqësuesit e mediave, ashtu edhe nga shoqëria civile, ndërkohë që më 24 shtator, gjatë Ditës së Vizitave Paqe e Drejtësi DHSK-ja i hapi dyert publikut për të vizituar sallën e gjyqit, si edhe për të pyetur gjithçka që dëshironin.

Gjatë vitit 2023, të gjithë anëtarët e personelit iu nënshtruan trajnimeve në lidhje me Politikën Kundër Ngacmimeve të DHSK-së, që është në vazhdim të politikës së DHSK-së për të mos toleruar asnjë formë ngacmimi.

Dëshirojmë t’u shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve të treta kontribuuese për mbështetjen e vazhdueshme për DHSK-në gjatë vitit 2023. Gjithashtu i jemi mirënjohës Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë për mbështetjen e dhënë gjatë operacioneve të kryera atje, si edhe Policisë së Kosovës për ndihmën e saj.

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
*Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës*

---

*Hagë, 22 dhjetor 2023*

Njëkohësisht u shprehim mirënjohje homologëve të DHSK-së në Shërbimin e Jashtëm të BE-së, në Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe Zyrën e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtëm Civil, për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre me DHSK-në gjatë vitit 2023.

Po kështu, u jemi mirënjohës shteteve, trupit diplomatik si dhe gjykatave ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara në Hagë për shkëmbimet konstruktive për çështje organizative dhe administrative.

Mirëpresim vitin që kemi përpara, në të cilin DHSK-ja do të vazhdojë t’i kryejë proceset në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e saj.

---

**Dr. Fidelma Donlon**  
*Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës*

---

# Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në janar 2011, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në maj 2011, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Force Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në shtator 2011.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, në prill 2014, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcaktoi se këto dhoma të dedikuara dhe të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, dhe do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë dhe do të kishin vetëm gjykatës ndërkombëtarë.

Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se këto dhoma të veçanta gjyqësore do të kishin seli në një

shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.

Në korrik 2014, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se TFHS-ja “do të jetë në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar pakësonte ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Në prill 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në prill 2016, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, që shënoi fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në shtator 2016, z. Dejvid Shvendiman (David Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në dhjetor 2016, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së. Ajo filloi punën në janar 2017.

---

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, nëntëmbëdhjetë gjykatës u emëruan në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 238 avokatë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

Në **maj 2018**, z. Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i Informimit të Gjykatës, në të cilin bëjnë pjesë OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas z. Dejvid Shvendiman, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua z. Xhek Smith.

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në zyrat e reja në Hagë.

Në **shkurt dhe prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u rimërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020**, bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u rimërua për një mandat katërvjeçar.

Më **16 mars 2021**, z. Pjetër Shala u arrestua në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më **15 prill 2021**.

Më **5 maj 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor I për çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës* dhe gjykimi filloi më **15 shtator 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **15 korrik 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor II në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* dhe gjykimi filloi më **7 tetor 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **8 maj 2022**, Prokurori i Specializuar Xhek Smith u rimërua për një mandat katërvjeçar.

Më **18 maj 2022**, Trupi Gjyqësor II shqiptoi aktgjykimin e parë në DHSK në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* duke i shpallur të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Më **17 qershor 2022**, z. Gucati dhe z. Haradinaj dorëzuan njoftimet përkatëse për apel kundër aktgjykimit.

Më **21 shtator 2022**, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës* Trupit Gjyqësor I.

---

Më **19 nëntor 2022**, pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting (Alex Whiting) u emërua Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

Më **1 dhe 2 dhjetor 2022**, Paneli i Gjykatës së Apelit mbajti seanca të apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.

Më **15 dhjetor 2022**, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve* Trupit Gjykues II.

Më **16 dhjetor 2022**, Trupi Gjykues I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, duke e shpallur të akuzuarin fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës, dhe vrasjes së paligjshme.

Më **2 shkurt 2023**, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, duke konfirmuar aktgjykimin, por duke i ulur dënimet në katër vjet e tre muaj burg.

Më **21 dhe 22 shkurt 2023**, filloi gjykimi i çështjes *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës* me deklaratat hyrëse të palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave.

Më **3 prill 2023**, filloi gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve*, me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **2 qershor 2023**, pas z. Xhek Smith si prokurore e specializuar u emërua znj. Kimbërlë P. Uest.

Më **31 korrik 2023**, autoritetet lokale në Shqipëri, në zbatim të një fletarrestimi të DHSK-së, arrestuan z. Dritan Goxhaj, i cili më pas u lirua me një vendim të Gjykatës së Apelit të Shqipërisë.

Më **5 tetor 2023**, Në Kosovë u arrestuan z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më **12 tetor 2023**, u ndryshua dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më **2 nëntor 2023**, u arrestua në Kosovë Isni Kilaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më **11 dhjetor 2023**, u arrestua në Kosovë z. Haxhi Shala mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më **12 dhjetor 2023**, u ndryshua dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më **14 dhjetor 2023**, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin e apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, duke konfirmuar pjesërisht aktgjykimin dhe e uli dënimin në 22 vjet burg.



## 2011



### Janar 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

### Shtator 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

## 2014

### Prill 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

## 2015

### Gusht 2015

Asambleja e Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

## 2016



### Prill 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DSK-së, që shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.



### Shtator 2016

Z. Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



### Dhjetor 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DSK-së.

## 2017

### Janar 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.



### Shkurt 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

### Mars 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

### Korrik 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

### Nëntor 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së.

## 2018



### Maj 2018

Z. Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.



### Shtator 2018

Z. Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas z. Dejvid Shvendiman.

## 2019



### Qershor 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në mjediset e reja.

## 2020

### Shkurt dhe prill 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.

### Prill 2020

Administratorja Fidelma Donlon riemërohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

### Shtator 2020

Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

### Nëntor 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi për krime të pretenduara kundër njerëzimit dhe për krime lufte.

### Dhjetor 2020

Kryetarja Ekaterina Trendafilova riemërohet për një mandat katërvjeçar.

## 2021



### Mars 2021

Z. Pjetër Shala arrestohet në Belgjikë mbi bazën e akuzave për krime lufte.



### Shtator 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

### Tetor 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

## 2022



### Mars 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

### Maj 2022

Prokurori i Specializuar Xhek Smith riemërohet për një mandat katërvjeçar.

### Maj 2022

Trupi Gjykues II shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

## Qershor 2022

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj dorëzojnë njoftimet për apel kundër aktgjykimit.

## Shtator 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*.



## Nëntor 2022

Pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting emërohet Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.



## Dhjetor 2022

Seanca e apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



## Dhjetor 2022

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së për krime lufte në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*.

## 2023

### Shkurt 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar Kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



### Shkurt 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës*.



### Prill 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve*.





## Qershor 2023

Znj. Kimbërlë Uest emërohet si Prokurorja e re e Specializuar.

## Korrik 2023

Z. Dritan Goxhaj arrestohet në Shqipëri nga autoritetet lokale i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe më pas lirohet nga Gjykata Shqiptare e Apelit.



## Tetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi të akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.


## Tetor 2023

Ndryshohet dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



## Nëntor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston në Kosovë z. Isni Kilaç i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.



## Dhjetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Haxhi Shala i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

## Dhjetor 2023


Ndryshohet dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



## Dhjetor 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas Shkëmbimit të Letrave në përputhje me legjislacionin e Kosovës, me anë të amendamentit kushtetues në vitin 2015. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



#### ■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit).

#### ■ DHSK-ja u krijua në përputhje me Shkëmbimin e Letrave dhe legjislacionin e Kosovës, dhe

- ka të njëjtat shkallë gjykimi si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese)
- ka seli jashtë Kosovës
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuuese.
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikurse përcaktohet në Ligj
- zbaton rregulloren e vet të procedurës dhe provave.

#### ■ DHSK-ja është institucion gjyqësor i përkohshëm

- që do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.

#### ■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin


- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve
  - që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
  - që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

#### ■ DHSK-ja merret vetëm me përgjegjësi penale individuale - nuk mund të gjykojnë grupe ose organizata.

#### ■ DHSK-ja lejon pjesëmarrjen e viktimave në procese gjyqësore.

- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.
- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.
- DHSK-ja ka Avokatin e Popullit, i cili vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në, ndër të tjera
  - përmes procedurës së parashtimit të ankesave prej personave

- në qoftë se ankesa e tyre ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në
- në rast të vonesave të paarsyeshme të një procesi në DHSK
- në qoftë se janë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike
- në qoftë se ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar
- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.







# DHOMAT

# 1

## Aktivitetet gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) patën veprimtari gjyqësore mjaft aktive në vitin 2023, vit në të cilin u shënuan një numër arritjesh të konsiderueshme. Konkretisht, më 2 shkurt 2023 u shqiptua aktgjykimi i parë i apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Guçatit dhe Nasim Haradinajt*, për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, që është gjithashtu çështja e parë e përfunduar plotësisht. Gjithashtu, më 14 dhjetor 2023 u shqiptua aktgjykimi i parë i apelit që përfshinte krime lufte, në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*. Filluan gjykimet e çështjeve *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve* dhe *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës*, ndërsa tre të akuzuar të tjerë dhe një i dyshuar u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit në tetor, nëntor dhe dhjetor, lidhur me krime kundër administrimit të drejtësisë.

Një tjetër person i akuzuar për frikësim të dëshmitarëve u arrestua në Tiranë, Shqipëri, më 31 korrik dhe transferimi i tij në objektin e paraburgimit do të varet nga një apel që ka paraqitur Prokuroria Shqiptare kundër vendimit të Gjykatës së Apelit e cila e ka hedhur poshtë kërkesën për transferimin e tij në DHSK.

Gjatë vitit 2023 të gjithë nivelet e Dhomave të Specializuara ishin të ngarkuara me shqyrtime çështjesh gjyqësore, duke përfshirë Gjykatësin e Vetëm, Gjykatësin e Procedurës Paraprake, dy Trupat Gjykues, Panelet e Gjykatës së Apelit, një Panel të Gjykatës Supreme dhe Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK). Për herë të parë që kur DHSK-ja u bë plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor, Kryetarja ishte e ngarkuar me shqyrtimin e procedurave gjyqësore në lidhje me uljen e dënimeve të dy personave të dënuar. Gjatë këtij viti, trupat gjykues dhe Kryetarja kanë lëshuar së bashku 1392 vendime dhe urdhra, 177 prej të cilëve u shqiptuan gojarisht.

a.

### PROCESET PARA GJYKATËSIT TË VETËM

#### Prokurori i Specializuar kundër Isni Kilajt

Më 2 nëntor 2023, në zbatim të një urdhri të dhënë nga Prokurori i Specializuar u arrestua në Kosovë z. Isni Kilaj. Fletarrestimi ishte lëshuar për vepra kundër administrimit të drejtësisë, duke përfshirë edhe pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkeljen e fshehtësisë së procesit. Z. Kilaj u transferua në objektin e paraburgimit më 3 nëntor 2023. Z. Kilaj bëri paraqitjen e parë para Gjykatësit të Vetëm, gjykatës Nikola Giju, më 4 nëntor 2023.



Z. Isni Kilaj gjatë paraqitjes së parë, 4 nëntor 2023

Më 8 nëntor 2023, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj, pasi konstatoi se ekzistonte dyshimi i bazuar që ai të kishte kryer vepra kundër administrimit të drejtësisë brenda juridiksionit të DHSK-së dhe, ndër të tjera, se për shkak të rrezikut të arratisjes, vazhdimi i mbajtjes së tij në paraburgim është i përshtatshëm.



Gjykatësi i Vetëm dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake Nikola Giju

## **b. PROCESET PARA GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

### **Prokurori i Specializuar kundër Ismet Bahtjarit dhe Sabit Januzit**

Më 5 tetor 2023, z. Ismet Bahtjari dhe z. Sabit Januzi u arrestuan në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në përputhje me fletarrestimet, urdhrat për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjykatësi Giju, më 2 tetor. Më 6 tetor, dy të akuzuarit u transferuan në objektin e paraburgimit. Aktakuza kundër z. Bahtjari dhe z. Januzi i akuzon ata për frikësim dhe tentim të pengimit të drejtësisë duke

kërcënuar seriozisht personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, edhe si individë, edhe duke marrë pjesë në veprimet e përbashkëta si grup.

Të dy të akuzuarit bënë paraqitjen e parë në 9 tetor para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe u vetë-deklaruan të pafajshëm për akuzat ndaj tyre. Gjithashtu, u mbajtën edhe dy konferenca mbi ecurinë e kësaj çështjeje: një më 12 tetor dhe tjetra më 6 nëntor.



Gjykatësi i Procedurës Paraprake Giju gjatë paraqitjes së parë të z. Januzi, 9 tetor 2023





Z. Januzi gjatë paraqitjes së parë, 9 tetor 2023



Z. Bahtijari gjatë paraqitjes së parë, 9 tetor 2023

## Prokurori i Specializuar kundër Haxhi Shalës

Më 4 dhjetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi akuzat kundër z. Haxhi Shala për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe lëshoi fletarrestimin për të. Sipas aktakuzës, z. Shala, bashkë me persona të tjerë, duke përfshirë edhe z. Januzi dhe z. Bahtijari, kanë bashkërenduar që, të paktën nga data 5 deri më 12 prill 2023, të kontaktojnë një dëshmitar që i ka dhënë ZPS-së ose DHSK-së informacion për krime që janë brenda juridiksionit të gjykatës, ose ka gjasa ta bëjë këtë.

Më 11 dhjetor z. Shala u arrestua në Kosovë dhe më 12 dhjetor u transferua në objektin e paraburgimit. Paraqitja e parë e z. Shala u krye më 13 dhjetor, ndërsa



Z. Haxhi Shala gjatë paraqitjes së parë, 13 dhjetor 2023

më 15 dhjetor u mbajt konferenca mbi ecurinë e çështjes gjyqësore, në të cilën ai u vetëdeklarua i pafajshëm për akuzat e ngritura kundër tij.


**C.**

## PROCESET PARA TRUPAVE GJYKUES

### Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Procesi gjyqësor në çështjen kundër z. Pjetër Shala filloi më 21 dhe 22 shkurt 2023 me deklaratat hyrëse të Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave. Ndaj z. Shala, që pretendohet se ishte anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me bazë në Kukës, Shqipëri, janë ngritur katër akuza për krime lufte, (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme). Këto krime lufte pretendohet se u kryen afërsisht në periudhën nga 17 maji 1999 deri më 5 qershor 1999 ndaj personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës që pretendohet se shfrytëzohej nga UÇK-ja.

Trupi Gjyqësor I, të cilit iu caktua kjo çështje, përbëhet nga gjykatësit Mapi Feld-Folia, (Kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë).



Z. Shala gjatë deklaratave hyrëse, 21 shkurt 2023



Trupi Gjykses II gjatë seancës së çështjes Shala, 27 mars 2023

ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave më 6 korrik, pasi kishte thirrur 10 dëshmitarë për të dëshmuar. Më 21 gusht bëri paraqitjen e provave Mbrojtësi i Viktimave dhe më 24 dhe 25 gusht 2023 u zhvillua konferenca përgatitore për Mbrojtjen. Më 15 shtator, Trupi Gjykses hodhi poshtë mocionin e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzës së vrasjes (akuza 4) sipas rregullës 130 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, dhe

më pas, më 20 shtator 2023, Mbrojtja filloi paraqitjen e provave. Deri në fund të vitit 2023, Mbrojtja kishte thirrur nëntë dëshmitarë dhe pritet që ta përfundojë paraqitjen e provave deri më 15 janar 2024.

Në këtë çështje marrin pjesë tetë viktimat, të gjithë shqiptarë të Kosovës.

*[T]rupi Gjykses [...] konstaton se dëshmitë që pritet të japin dëshmitarët W04405, W04441, W04280 dhe W04440 janë relevante për çështjen gjyqësore, pasi që dëshmitarët pritet të japin informacion në mbështetje të besueshmërisë së dëshmitarëve të ZPS-së [...]. Pritet që ata të dëshmojnë për njohurinë (ose mungesën e saj) për rastet e ndalimit arbitrar dhe/ose keqtrajtimin të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës, dhe/ose për planimetrinë e fabrikës së metalit në Kukës [...].*

*Sipas kërkesës së Mbrojtjes, Trupi Gjykses konstaton se është e përshtatshme të dëgjohen drejtpërdrejt dëshmitë e të katër dëshmitarëve në selinë e Dhomave të Specializuara në Hagë.*

KSC-BC-2020-04/F00683/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 121(3) të Rregullores për të Thirrur Dëshmitarët W04405, W04441, W04280 dhe W04440, 16 nëntor 2023, para. 14, 17.

## Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Procesi i gjyqimit në çështjen kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi filloi më 3 prill 2023 me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar. Deri në fund të vitit 2023, ZPS-ja kishte thirrur për të dëshmuar 39 dëshmitarë, ndërkohë që ishin pranuar si prova 138 deklaratat të dëshmitarëve.

Ndaj z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi janë ngritur 10 akuza – katër akuza për krime lufte dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit.

Në aktakuzë thuhet se krimet për të cilat akuzohen janë kryer në periudhën, të paktën nga marsi 1998 deri në shtator 1999, dhe kanë ndodhur në disa vende të ndryshme në Kosovë, si edhe në Kukës dhe Cahan, të Shqipërisë Veriore. Pretendohet se këto krime u kryen kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.



Seancë nga çështja gjyqësore Hashim Thaçi dhe të tjerët, 3 prill 2023

Trupi Gjykses II, që caktoi Kryetarja për këtë çështje gjyqësore, përbëhet nga gjykatësit Çarls Smith III

(Kryegjykatës), Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor (rezervë).



Trupi Gjykses II gjatë deklaratave hyrëse të çështjes gjyqësore Thaçi dhe të tjerët, 3 prill 2023

Në këtë çështje gjyqësore marrin pjesë 141 viktime.

*Në analizën e saj, Gjykata Kushtetuese nuk sugjeron se, nëse dëshmitari në gjyq jep dëshmi që është materialisht e ndryshme nga deklaratat që ka dhënë dëshmitari gjatë fazës hetimore, rregulla 155(2) merr përparësi ndaj rregullës 143(2)(c). Përkundrazi, siç duket qartë nga analiza e Gjykatës Kushtetuese, pranimi i një deklaratë të mëparshme mospërputhëse të dhënë në fazën e hetimeve sipas rregullës 143(2)(c) është një mjet që Trupi Gjykses mund ta përdorë kur përmbushen kriteret e kësaj rregulle. As në aktvendimin e Gjykatës Kushtetute dhe askund tjetër nuk gjen mbështetje sugjerimi që rregulla 155 është lex specialis ndaj rregullës 143(2)(c). Për më tepër, një interpretim i tillë do ta nxirrte rregullën 143(2)(c) të parëndësishme.*

KSC-BC-2020-06/F01821, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Dëshmitarit W03827 sipas Rregullës 143(2) dhe mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikim, 28 shtator 2023, para. 25.

## Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj u akuzuan për katër vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, për frikësim, për hakmarrje, dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Shqiptimi i aktgjykimit të Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë çështje më 2 shkurt 2023 ishte një arritje e rëndësishme e DHSK-së. Ky ishte aktgjykimi i parë i apelit i shqiptuar në DHSK. Paneli i Gjykatës së Apelit, i përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikar (kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen, konfirmoi konstatimin e Trupit Gjykues se z. Gucati dhe z. Haradinaj janë fajtorë për frikësim gjatë procedurës penale, për shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të

paautorizuar të informacionit sekret të dhënë gjatë procedurave zyrtare, dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurave përmes zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

Paneli i Gjykatës së Apelit, me shumicë votash, gjithashtu konfirmoi dënimin që Trupi Gjykues I e shqiptoi për z. Gucati dhe z. Haradinaj, për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë. Paneli i Gjykatës së Apelit, me shumicë votash, ia uli dënimin z. Gucati dhe z. Haradinaj në katër vjet dhe tre muaj burgim, ku llogaritet edhe koha e paraburgimit, dhe me një gjobë prej 100 Euro secilit.



Paneli i Gjykatës së Apelit gjatë dhënies së aktgjykimit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, 2 shkurt 2023



Z. Gucati dhe z. Haradinaj gjatë shqiptimit të aktgjyimit të apelit të tyre, 2 shkurt 2023

*Natyra e krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe rrethanat në të cilin u kryen ato, bëjnë të nevojshme mbështetjen te dëshmitë gojore. Është me rëndësi themelore për përmbushjen e misionit të Dhomave të Specializuara që individët të cilët vijnë për të dhënë dëshmi, shpesh për përvoja tronditëse ose të vështira, ta bëjnë këtë pa pasur frikë.*

*Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi është në themel të çdo sistemi të drejtësisë penale, përfshirë edhe në Dhomat e Specializuara. Rrjedhimisht, kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e procesit dhe sigurinë e dëshmitarëve.*

---

Përmbledhja e Aktgjyimit të Apelit në Çështjen Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt (KSC-CA-2022-01), 2 shkurt 2023, f. 2.

## Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Në aktakuzën ndaj z. Salih Mustafa janë ngritur katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) të kryera në prill 1999. Sipas aktakuzës, gjatë periudhës në fjalë, z. Mustafa ishte komandant i një njësitë gueril në zonën operative të UÇK-së në Llap.

Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I e shpalli z. Mustafa fajtor për torturë, ndalim arbitrar dhe vrasje të paligjshme si krim lufte dhe e dënoi atë me 26 vjet burgim. Trupi Gjykses e shpalli z. Mustafa të pafajshëm për krimin e trajtimit mizor si krim lufte.

Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi urdhrin për zhdëmtim në këtë çështje, që urdhëron z. Mustafa të paguajë 207,000 Euro si kompensim për dëmin e shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat ishte dënuar. Në këtë çështje janë dhjetë viktima, që të gjithë të përkatësisë etnike shqiptare.

Pasi z. Mustafa e apeloj aktgjykimin më 3 shkurt, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit të përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikar (Kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen. Për këtë çështje u zhvillua një seancë apeli më 26 tetor 2023.



Z. Mustafa gjatë seancës së apelit, 26 tetor 2023

Shqiptimi i aktgjykimin të Panelit të Gjykatës së Apelit për këtë çështje më 14 dhjetor 2023 ishte një arritje e madhe për DHSK-në. Për DHSK-në ky ishte aktgjykimi i parë i apelit që kishte lidhje me krime lufte. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi dënimet ndaj z. Mustafa

për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte, por e pranoi pjesërisht apelin e Z. Mustafa për masën e dënimit. Për këtë arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit ia uli z. Mustafa dënimin nga 26 vjet burgim në 22 vjet, ku llogaritet edhe koha e paraburgimit.

Paneli i Gjykatës së Apelit theksoi se aktgjykimi “është një hap i rëndësishëm për t’u dhënë drejtësi viktimave dhe për të siguruar llogaridhënie” dhe se ulja e dënimit të z. Mustafa “nuk do të thotë në asnjë mënyrë se krimet për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar nuk janë të rënda.”

KSC-CA-2023-02, Përmbledhja e Aktgjykimin të Apelit, 14 dhjetor 2023, f. 1, 21.

## Apelimet e ndërmjetme

Me përparimin e ndjeshëm që u bë në çështjet gjyqësore të DHSK-së, gjatë vitit 2023 Panelet e Gjykatës së Apelit ishin të ngarkuara edhe me një gamë të gjerë apelesh.

Ato dhanë vendime mbi një numër çështjesh të apelueshme, duke përfshirë vazhdimin e paraburgimit, pjesëmarrjen e viktimave, marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe mocionet lidhur me provat jогоjore.

*Në këtë fazë, Paneli gjykon se, nëse një person që i është refuzuar kërkesa dëshiron të paraqesë informacion të ri për të cilin nuk kishte dijeni ose nuk ishte në zotërim të kërkuarit në kohën kur është bërë kërkesa e parë, rast ky që kërkon shqyrtim të ri të kërkesës së tyre për t'u pranuar në procesin gjyqësor, ai mund ta bëjnë këtë duke e paraqitur nëpërmjet ZPS-së sërish kërkesën për pjesëmarrje përpara një paneli kompetent të ngarkuar me atë çështje në kohën e caktuar për t'u rivlerësuar në bazë të informacionit të ri. Megjithatë një gjë e tillë nuk përcaktohet shprehimisht në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara, Paneli i Apelit nuk sheh asnjë pengesë për një veprim të kësaj natyre dhe gjykon se do të ishte në interes të drejtësisë dhe do të mbronte interesat dhe të drejtat e vetjake të viktimave.*

KSC-BC-2020-06/IA026/F00011/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin Kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 26 prill 2023, para. 30.

*Megjithatë një trup gjykues mund të mos ketë detyrim që të marrë në pyetje dëshmitarë ose të kërkojë prova në lidhje me fakte ose aspekte që nuk janë diskutuar nga palët, Rregullorja i jep atij pa asnjë dyshim autoritetin dhe diskrecionin për ta bërë një gjë të tillë si pjesë e detyrës për të ndihmuar në përcaktimin e të vërtetës.*

KSC-BC-2020-06/IA028/F00011/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kundër Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjyqësor, 4 korrik 2023, para. 34.

e.

## PANELI I GJYKATËS SUPREME

Më 2 dhe 3 maj 2023, z. Gucati dhe z. Haradinaj paraqitën kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në bazë të nenit 48(6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores. Paneli i Gjykatës Supreme, i përbërë nga gjykatësit Ekaterina Trendafilova (Kryegjykatëse),

Kristinë van den Vajngart dhe Daniel Fransen e lëshoi vendimin më 18 shtator 2023, duke i hedhur poshtë plotësisht të dy kërkesat. Paneli gjykoi se nuk kishte ndodhur asnjë shkelje thelbësore e procedurës dhe asnjë shkelje e ligjit penal.

*Paneli rikujton se mbrojtja e ligjshmërisë, siç parashihet në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe rregullat 193 dhe 194 të Rregullores, është një mjet i jashtëzakonshëm. Ajo nuk është krijuar për t'i hapur rrugë të gjerë apelimit. Përkundrazi, dhe ngjashëm me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, mbrojtja e ligjshmërisë kufizohet në raste specifike të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.*

KSC-SC-2023-01/F00021, Vendim mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 18 shtator 2023, para. 9.

**f.****DHOMA E SPECIALIZUAR E GJYKATËS KUSHTETUESE**

Gjatë vitit 2023, DHSGJK-ja mori në shqyrtim dy kërkesa referuese. E para u paraqit nga z. Shala më 11 korrik 2023. Z. Shala argumentonte se konstatimi i Trupit Gjykues se deklaratat që ai i dha Policisë Gjyqësore Federale Belge në vitin 2016 nuk ishin të papranueshme si prova shkelte të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të drejtën për mjet juridik efektiv sipas neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës, dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Më 29 gusht 2023 DHSGJK-ja hodhi poshtë kërkesën referuese të z. Shala, duke e gjykuar kërkesën referuese si të parakohshme, sepse procesi penal në këtë çështje gjyqësore vazhdonte ende.

Kërkesa e dytë referuese u dorëzua nga z. Haradinaj më 21 nëntor 2023. Në fund të vitit 2023, kjo kërkesë referuese ishte ende në pritje për t'u shqyrtuar nga DHSGJK-ja.

*[...] u takon së pari dhomave penale të vlerësojnë nëse pretendimi i ngritur për shkelje procedurale ka ndonjë bazë dhe nëse kjo duhet ndrequr në procesin në vijim. Kjo pasqyron parimin e përgjithshëm sipas të cilit përbushja e kriterëve të gjykimit të drejtë duhet të shqyrtohet në secilin rast duke mbajtur parasysh zhvillimin e procesit në tërësi dhe jo në bazë të shqyrtimit të izoluar të një aspekti të veçantë apo të një incidenti të vetëm procedural, përpos rastit kur, pas marrjes së vendimit për akuzat e ngritura dhe përfundimit të procesit nga dhoma penale, mund të konstatohet se, një faktor i veçantë, qoftë edhe një i cili ndikoi në fazat e hershme të procesit, ishte aq vendimtar saqë e bën automatikisht të padrejtë procesin në tërësi.*

KSC-CC-2023-121/F00006, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32, dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 29 gusht 2023, para. 27.

**g.****PROCEDURAT PARA KRYETARES**

Më 12 tetor 2023, Kryetarja Trendafilova lëshoi vendimet e para të DHSK-së mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimeve. Kryetarja ishte njoftuar se deri në 25 korrik 2023 z. Gucati dhe z. Haradinaj kishin kryer dy të tretat e dënimit, duke plotësuar në këtë mënyrë kriterin për t'u shqyrtuar për ulje dënimi sipas nenit 51(2) të ligjit.

Kushtet do të mbeten në fuqi për gjithë kohën e dënimit që i është dhënë z. Gucati nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht deri më 24 dhjetor 2024. Në rast shkelje të ndonjërit nga kushtet e vëna, vendimi do të anulohet dhe z. Gucati do të burgoset sërish.

Kryetarja mori në shqyrtim të gjithë informacionin që kishte në dispozicion dhe, pasi u këshillua me gjykatësit e trupit gjykues që dha dënimin dhe pas seancave të drejtpërdrejta ndaras me z. Gucati dhe z. Haradinaj, vendosi që dënimi i z. Gucati duhej modifikuar për të mundësuar lirin e tij me kushte në Kosovë më 18 tetor 2023 ose përpara kësaj date.



Kryetarja vendosi që dënimi i z. Haradinaj mund të modifikohet me kushte nëse ai do të dëshmonte brenda një periudhe të caktuar se e respektonte kuadrin rregullator të objektit të paraburgimit të DHSK-së. Më 12 dhjetor 2023, pasi kishte marrë raportin e Administratores mbi sjelljen e z. Haradinaj në objektin e paraburgimit, Kryetarja vendosi ta modifikonte dënimin e z. Haradinaj për të mundësuar lirin e tij me kushte në Kosovë më 14 dhjetor 2023, ose rreth kësaj date.

Kushtet do të mbeten në fuqi për gjithë kohën e dënimin që i është dhënë z. Haradinaj nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht deri më 24 dhjetor 2024. Në rast shkelje të ndonjërit nga kushtet e vëna, vendimi do të anulohet dhe ai do të burgoset përsëri në objektin e paraburgimit.



Kryetarja Ekaterina Trendafilova

## 2

# Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksione gjyqësore sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit, gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera vetëm për shkak të këtij emërimi. Për më tepër, gjykatësit shpërblehen vetëm kur i cakton Kryetarja të ushtrojnë detyra zyrtare. Gjykatësit e emëruar, për aq sa është e mundur, i kryejnë funksionet e tyre gjyqësore nga distanca.

Në korrik 2023, u publikua një ftesë për propozime për listën rezervë të kandidaturave për të hyrë në Regjistër që të sigurohej funksionimi i efektshëm i veprimtarisë së vazhdueshme dhe të pandërprerë të DHSK-së. Ftesa do të mbyllet më 15 mars 2024. Çdo emërim në Regjistër do të hyjë në fuqi menjëherë sapo të jetë i pamjaftueshëm numri i gjykatësve në Regjistër. Lista rezervë e Regjistrit ka si qëllim të sigurojë që, në raste dorëheqjesh së gjykatësve në të ardhmen, të mund të zëvendësohen menjëherë, duke parandaluar kështu çdo vonesë në proceset gjyqësore.

### a.

## PLENARJA VJETORE

Më 24 mars 2023, gjykatësit u mbledhën në DHSK për plenaren e tyre të tetë. Gjatë plenares, gjykatësit miratuan një ndryshim në Kodin e Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Kodi i Etikës Gjyqësore), të miratuar në plenaren e parë në mars 2017.

Ndryshimi përputh Kodin e Etikës Gjyqësore me Politikën Kundër Ngacimit të DHSK-së, të miratuar në dhjetor 2022.

Me këtë ndryshim në Kodin e Etikës Gjyqësore, që aktualisht ndalon çdo formë diskriminimi, keqtrajtimi, duke përfshirë edhe keqtrajtimin seksual, dhe shpërdorimin e pushtetit, gjykatësit kishin për qëllim forcimin e mëtejshëm të përkushtimit të tyre për llogaridhënie dhe demonstrimin e synimit për të qenë të detyruar nga parimet e rëndësishme që vlejnë për të gjithë personat që punojnë në DHSK.

Gjykatësit ndoqën edhe prezantime të paraqitura nga Administratorja dhe drejtuesit e njësive të Zyrës Administrative.

### b.

## MBLEDHJA E GJYKATËSVE

Më 22 shtator 2023, gjykatësit u mbledhën në Hagë për një seminar në të cilin të ftuar të shquar bënë prezantime dhe diskutuan me gjykatësit çështje të rëndësishme të fushës së të drejtës penale ndërkombëtare.



Seminari i gjykatësve, 22 shtator 2023



Gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës

# Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjykatëse Ekaterina Trendafilova  
Kryetare  
(Bullgari)



Gjykatës Çarls L. Smith III  
Nënkryetar  
(SHBA)



Gjykatës Vidar Stensland  
Gjykatës Kushtetues  
(Norvegji)



Gjykatës Antonio Balsamo  
Gjykatës Kushtetues  
(Itali)



Gjykatës Rumen Nenkov  
Gjykatës Kushtetues  
(Bullgari)



Gjykatëse Romina Inkuți  
Gjykatës Kushtetues Rezervë  
(Itali)



Gjykatëse Kristině van den  
Vajngart  
(Belgjikë)



Gjykatëse Mischelė Pikar  
(Francë)



Gjykatës Tomas Laker  
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gati  
(Itali)



Gjykatës Roland Dekers  
(Holandë)



Gjykatës Kai Ambos  
(Gjermani)



Gjykatës Keneth Roberts  
(Kanada)



Gjykatëse Mapi Feld-Folia  
(Holandë)



Gjykatës Kristof Barte  
(Gjermani)




Gjykatës Vladimir Mikula  
(Çekia)



Gjykatës Ginel Metro  
(Zvicër)



Gjykatës Nikola Giju  
(Francë)



Gjykatës Zhilber Biti  
(Francë)



Gjykatës Daniel Fransen  
(Belgjikë)



Gjykatës Fergal Gejnor  
(Irlandë)



Gjykatëse Nina Jorgensen  
(Norvegji)

Gjatë vitit 2023, Kryetarja Trendafilova vazhdoi të informonte publikun dhe palët e interesuara për aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim, Kryetarja u takua me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE), të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuuese, të shtetit pritës dhe të Kosovës.

Më 18 janar 2023, Kryetarja Trendafilova u takua me Kryetaren e Komitetit Politik dhe të Sigurisë (KPS) të Bashkimit Evropian, znj. Delfinë Pronk, për të diskutuar çështje që lidhen me DHSK-në, duke përfshirë edhe finalizimin e marrëveshjeve dypalëshe për caktimin e shtetit të kryerjes së dënimit.

Më 17 maj 2023, Kryetarja vizitoi Brukselin, ku pati takime me drejtoreshën ekzekutive për Evropën dhe Azinë Qendrore të Shërbimit të Jashtëm të BE-së znj. Angelina Ajhorst (Angelina Eichhorst), komandantin e Operacioneve Civile, z. Stefano Tomat dhe anëtarë të Komitetit për Aspekte Civile të Menaxhimit të Krizave për të diskutuar çështje me rëndësi për DHSK-në.

Më 14 shtator 2023, Kryetarja vizitoi Brukselin ku u takua përsëri me Kryetaren e KPS-së, znj. Pronk dhe komandantin e Operacioneve Civile, z. Stefano Tomat. Kryetarja diskutoi proceset gjyqësore në vazhdim dhe disa nga sfidat me të cilat përballet Gjykata.

Kryetarja vizitoi Kosovën nga data 28 nëntor deri më 1 dhjetor 2023. Gjatë vizitës ajo drejtoi një takim për komunikim dhe ndërgjegjësim me shoqërinë civile dhe mediat, si dhe u takua me studentë të drejtësisë. Ajo u takua edhe me zëvendësministrin e Drejtësisë të Kosovës Blerim Sallahu dhe pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit ndërkombëtar, duke përfshirë ambasadorët në Kosovë të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese; shefin e zyrës së BE-së në Kosovë dhe përfaqësuesin e posaçëm të BE-së dhe shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Për të forcuar edhe më tej marrëdhëniet e DHSK-së me palët e tjera të jashtme të interesuara dhe me shoqërinë civile, Kryetarja pati takime me anëtarë të komuniteteve diplomatike, ligjore dhe akademike.

*Shpeshherë kërkohet kurajë e madhe dhe ndjenjë përgjegjësie publike që njerëzit të dalin dhe të pranojnë të tregojnë historinë e tyre; të dëshmojnë para DHSK-së. Me këtë veprim ata ndihmojnë drejtësinë dhe sundimin e ligjit.*

*Aktgjykimet, qofshin edhe më të mirat, nuk mund të merren në dëm të jetës dhe mirëqenies së njerëzve.*

*Prandaj, mbrojtja e dëshmitarëve është përparësia më e lartë për DHSK-në.*

---

Kryetarja Trendafilova, intervista për organe të mediave në Kosovë dhe Shqipëri.

# MARRËDHËNIET ME JASHTË

# Marrëdhëniet me jashtë

Krahas shtimit të ndjeshëm të aktiviteteve gjyqësore, Kryetarja dhe Administratorja kanë vazhduar të luajnë rol të rëndësishëm për t'i shpjeguar publikut në Kosovë dhe rajon se si punon Gjykata për të garantuar procese gjyqësore të drejta, të sigurta dhe të efektshme, në përputhje me mandatin e saj dhe me standardet më të larta të së drejtës penale ndërkombëtare.

Më 20 janar 2023, Shkëlqesia e Saj Kristina Kokinakis, zëvendës drejtoreshë administrative për marrëdhënie globale dhe drejtoreshë për Vlera dhe Marrëdhënie Shumëpalëshe e Shërbimit të Jashtëm të BE-së, vizitoi gjykatën dhe u takua me Kryetaren, Administratoren dhe me Ushtruesin e Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

Më 30 janar 2023, Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar mirëpritën në mjediset e DHSK-së Komitetin Politik dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (BE), ku paraqitën një përmbledhje të veprimtarive gjyqësore të DHSK-së dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), diskutuan arritjet e rëndësishme të deritanishme dhe prekën disa nga sfidat që i dalin gjykatës.

Nga 15 deri më 16 mars 2023, Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar mirëpritën në mjediset e DHSK-së një delegacion nga Shërbimi i Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe Zyrës për Planifikim dhe Drejtim Civil.

Nga 3 deri më 6 prill 2023, Rrjeti i Informimit i Gjykatës së DHSK-së (RRIGJ) vizitoi DHSK-në në Hagë. Gjatë këtyre ditëve ata ndoqën deklaratat hyrëse në procesin gjyqësor *Thaçi dhe të tjerët* dhe morën pjesë në një seminar njëditor. Me anëtarët e RRIGJ-së u takuan edhe Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar që dhanë një vështrim të shkurtër të përgjithshëm të punës në vazhdim në Gjykatë dhe dëgjuan mendimet e anëtarëve të RRIGJ-së për aktivitetet e DHSK-së për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Më 12 korrik 2023, drejtuesit e lartë mirëpritën në Gjykatë shefin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe autoritetin emëruar, gjeneral-major Xhovani Pietro Barbano, dhe diskutuan për veprimtaritë gjyqësore aktuale të DHSK-së dhe ZPS-së dhe për mbështetjen që jep EULEX-i në këtë drejtim.



Vizita e Komitetit Politik dhe të Sigurisë së BE-së në DHSK dhe ZPS, 30 janar 2023

Gjatë javës së 17 korrikut 2023, Kryetarja dhe Administratorja patën disa takime dypalëshe me shtete dhe përfaqësues të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Nju Jork për të dhënë informacion mbi mandatin e DHSK-së, mbi arritje të ndryshme dhe mbi sfidat me të cilat përballlet Gjykata. Ato vizituan përsëri Nju Jorkun gjatë javës së 27 tetorit 2023 në një takim të organizuar nga BE-ja, ku informuan delegacionet e BE-së dhe shteteve të tjera anëtare për gjykatën dhe arritjet e saj.

Më 21 shtator 2023, Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar mirëpritën në Gjykatë një delegacion nga Shërbimi i Jashtëm i BE-së dhe Grupit Bazë për tribunalin e krimeve të agresionit kundër Ukrainës dhe paraqitën një përmbledhje të mandatit dhe punës së DHSK-së dhe ZPS-së.

Më 27 shtator 2023, Grupi i Punës i BE-së për Rajonin e Ballkanit Perëndimor vizituan DHSK-në dhe ZPS-në, morën pjesë në prezantime të drejtuesve të lartë dhe patën rastin të bënin pyetje, si edhe të vizitonin sallën e gjyqit dhe galerinë për publikun.

Më 8 dhjetor 2023, në seancën vjetore të informimit drejtuesit e lartë përditësuan shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese me bazë në Hagë për punën e DHSK-së dhe ZPS-së.

Kryetarja dhe Administratorja u takuan gjithashtu edhe me ambasadorë, autoritete ndërkombëtare dhe shtetërore, përfshirë ambasadorën e SHBA-së për Drejtësi Penale Globale, Sh. S. Beth Van Shak, Sh. T. Xhejms Braun, ministër shteti i Departamentit Irlandez të Drejtësisë, një delegacion nga Gjykata Penale Speciale për Republikën e Afrikës Qendrore, një delegacion gjykatësish nga Italia, një delegacion gjykatësish nga Franca, një delegacion gjykatësish nga ushtria holandeze, një delegacion gjykatësish nga Ukraina dhe një delegacion gjykatësish nga Jordania.



Kryetare Ekaterina Trendafilova dhe Administratore Fidelma Donlon gjatë vizitës së Grupit të Punës së BE-së për Rajonin e Ballkanit Perëndimor.




## VEPRIMTARITË KRYESORE TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA 2023



DERI NË FUND TË VITIT 2023,  
VAZHDUAN GJYKIMET NË  
**5 ÇËSHTJE GJYQËSORE ME  
8 TË AKUZUAR DHE 1 TË DYSHUAR**



AKTGJYKIME APELI NË  
**2 ÇËSHTJE GJYQËSORE**



U MBAJTËN **137 SEANCA PUBLIKE** QË  
U TRANSMETUAN NË INTERNET  
NË **3 GJUHËT** E GJYKATËS



**130 000 SHIKIME TË  
FAQEVË ME TRANSMETIME**



DËSHMUAN **60 DËSHMITARË**  
NË **DY ÇËSHTJE GJYQËSORE**



PANELET LËSHUAN MBI  
**1 300 VENDIME DHE URDHRA**



U PËRKTHYEN **892 DOCUMENTE**  
ME **MBI 10 000** FAQE NË VITIN 2023



U PRANUAN **88 VIKTIMA**  
TË TJERA PËR TË MARRË PJESË  
NË **DY ÇËSHTJE GJYQËSORE**



RRETH **1 000 PERSONA**  
NË KOSOVË MORËN  
PJESË NË AKTIVITETE INFORMIMI  
DHE NDËRGJEGJËSIMI

# ZYRA ADMINISTRATIVE

# Zyra Administrative

Zyra Administrative ofron në mënyrë të paanshme dhe të pavarur shërbime administrative për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) si edhe shërbime mbështetëse gjyqësore. Ajo drejtohet nga Administratorja, Dr. Fidelma Donlon, e cila këshillohet me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar lidhur me çështje institucionale.

Shërbimet administrative që i jep Zyra Administrative Dhomave dhe ZPS-së, përfshijnë buxhetin, financimin, prokurimin, teknologjinë e informacionit, administrimin e objektit, burimet njerëzore dhe sigurinë. Shërbimi i mbështetjes gjyqësore përfshin mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, si dhe shërbimet e përkthimit me shkrim dhe gojë, administrimin e Gjykatës dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Gjatë vitit 2023, pati arritje të shumta gjyqësore dhe punonjësit e Zyrës Administrative, nën udhëheqjen e Administratorës, vazhduan të japin shërbime të cilësisë më të lartë në mbështetje të një menaxhimi administrativ të frytshëm të DHSK-së dhe ZPS-së, si edhe të procedurave të drejta, të sigurt dhe të efektshme në Gjykatë. Kjo punë përfshin edhe kryerjen e tri vizitave nën ruajtje të të paraburgosurve në Kosovë për arsye humanitare, në përputhje me urdhrat e paneleve përkatës, transferimin e sigurt të tre të akuzuarve të tjerë dhe një të dyshuari në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe transferimin e dy të dënuarve në Kosovë, sipas modifikimit që Kryetarja i bëri dënimit të tyre. Me hapjen e procedurave të tjera gjyqësore puna për komunikim dhe ndërgjegjësim vazhdoi të jetë përparësi, si dhe angazhimi me Rrjetin e Informimit të Gjykatës së DHSK-së.

Bashkimi Evropian (BE) është burimi kryesor i financimit për DHSK-në dhe ZPS-në. Administratorja nënshkruan marrëveshjen për subvencionimin në emër të DHSK-së dhe ZPS-së. Veprimtaritë për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së në Kosovë financohen nga një donacion dyvjeçar nga Zvicra.

Administrimi i shëndetshëm financiar është thelbësor për DHSK-në dhe ZPS-në. Administratorja siguron që burimet buxhetore të përdoren si duhet dhe që të



Administratore Fidelma Donlon

kryhen proceset e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Deri në fund të vitit 2023, DHSK-ja dhe ZPS-ja kishin kaluar 18 auditime të jashtme pa asnjë vërejtje.

Në vazhden e veprimtarive intensive në Gjykatë, thelbësor ishte shfrytëzimi maksimal i burimeve njerëzore. Rritja e numrit të posteve të lira pas negociatave të Administratorës në vitin 2023 bëri të mundur punësimin e personelit të nevojshëm për administrimin e shpejtë të proceseve gjyqësore.

Administratorja, së bashku me drejtues të tjerë të rëndësishëm, kanë mirëpritur vizita të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese në mjediset si edhe kanë takuar përfaqësuesit e tyre gjatë misioneve përkatëse. Në këto takime ajo ka vazhduar t'iu bëjë thirrje shteteve anëtare të finalizojnë marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh në lidhje me zbatimin e dënimeve dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, që të dyja thelbësore për suksesin e gjykatës.

Kah fundi i vitit, në bazë të një vendimi të marrë më 1 dhjetor nga Trupi Gjyqësor II në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, Administratorja zbatoi ndryshimet në kushtet e paraburgimit për tre nga të akuzuarit. Këto kushte përfshinin një sistem vizitash të miratuar paraprakisht nga Administratorja dhe mbikëqyrje aktive të vizitave personale, me përjashtim të takimeve me Mbrojtjen, si edhe një sistem për identifikimin dhe mohimin e vizitave për persona për të cilët Administratorja vlerëson se ka të dhëna të besueshme për sjellje që mund të cenojnë integritetin e procedurës gjyqësore ose respektimin e Rregullores së Paraburgimit.

Personeli i Zyrës Administrative vazhdoi të jetë i angazhuar në avancimin e prioriteteve strategjike të përcaktuara nga Administratorja në vitin 2021 në lidhje me administrimin e dokumentacionit dhe të provave.

Në lidhje me sistemin elektronik të administrimit të gjykatës, vazhdoi puna për të siguruar zgjerim të mjaftueshëm të kapacitetit duke pasur parasysh numrin e shtuar të proceseve gjyqësore në DHSK, ndërkohë që përgatitej një ripërtëritje e plotë e sistemit, duke përfshirë edhe testimin e hollësishëm të një versioni dhe një platforme të re. Me këtë ripërtëritje parashikohet që sistemi nuk do të kërkojë përditësime të tjera. Deri në fund të vitit 2023, në sistem ishin administruar 2 794 vendime dhe parashtrime, si dhe 11 682 materiale të nxjerra, gjithsej 144 GB. Sa i përket projektit për ruajtje dhe arkivim, të gjitha asetet e informacionit të DHSK-së, si në formë fizike, ashtu

edhe në formë digjitale, u analizuan për të siguruar që Regjistri i Aseteve të Informacionit të jetë i plotë.

U analizuan mbi 23 TB dhe 226 metra asete të informacionit, që prodhuan informacion të vlefshëm për vlerësimin e kapacitetit të nevojshëm për një arkiv afatgjatë në të ardhmen.

Bashkëpunimi i Zyrës Administrative me shtetin pritës vazhdoi edhe në vitin 2023. Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe Marrëveshjes me Shtetin Pritës, agjencitë e shtetit pritës ofrojnë shërbime thelbësore, ku përfshihen oficerët e paraburgimit, transferimi i të ndaluarve, lehtësimi i marrjes së vizave për personat e nevojshëm në procesin gjyqësor si dhe shërbime në fushën e sigurisë dhe të vlerësimit të rrezikut. Për veprimet e saj në Kosovë, DHSK-ja ka vazhduar të gëzojë mbështetje të rëndësishme nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

## 1

# Kabineti i Administratores

Në punën e saj, Administratorja mbështetet nga Kabineti i Administratores (KA). Zyra përfshin një sërë detyrash, si mbështetja ligjore dhe joligjore në lidhje me proceset gjyqësore dhe administrimin e Gjykatës, marrëdhëniet me shtetin pritës dhe ato diplomatike, marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit, raportimin e rregullt në BE, si dhe shërbimet protokollare. Në përgjegjësitë e KA-së përfshihet gjithashtu edhe Njësia e Administrimit të Informacionit (AdmInfo).

Në vitin 2023, ekipi juridik i Kabinetit të Administratores ofroi këshilla për një mori çështjesh, duke përfshirë kërkesat për bashkëpunim dhe ndihmë nga shtetet në çështje që nga ekstradimi e deri te lehtësimi i dhënies së dëshmimeve nga dëshmitarët përmes lidhjeve elektronike. Ekipi ligjor u përqendrua gjithashtu edhe në themelimin e kuadrit ligjor për krijimin e një fondi për dëmshpërblime, dhënien e këshillimeve ligjore në çështjet e paraburgimit dhe ato operative, dhe në dhënien e mbështetjes ligjore në fushën e burimeve njerëzore, mbrojtjes së të dhënave, prokurimin dhe kontratat tregtare dhe miradministrimin në përgjithësi. Bashkë me Njësinë e Burimeve Njerëzore, ekipi ligjor iu ofroi të gjithë punonjësve seanca informative mbi Politikën Kundër Ngacimit dhe siguroi zbatimin e plotë të

procedurave të kësaj politike. Gjithashtu, në emër të Administratores, ekipi ligjor administroi 262 parashtrime në proceset gjyqësore para DHSK-së për tema si pjesëmarrja e viktimave, mbrojtja e dëshmitarëve, paraburgimi, vizitat nën ruajtje dhe lirimet me kusht.

Kabineti i Administratores vazhdoi të mbështesë Administratoren në punën e saj për komunikim dhe ndërgjegjësim, veçanërisht në arritjen e bashkëpunimit shtetëror për të përfunduar marrëveshjet për bashkëpunim në lidhje me zbatimin e dënimeve dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.


Mbështetja në fushën e protokollit u përqendrua në bashkëpunimin me shtetin pritës për t'iu lehtësuar hyrjen në Holandë pjesëtareve të familjeve që vizitonin të paraburgosurit si edhe për sigurimin e marrëdhënieve të protokollit të brendshëm.

Gjithashtu, KA-ja drejtoi grupet e veçanta të punës për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit elektronik të administrimit gjyqësor, *Legal Workflow*, dhe për ruajtjen dhe arkivimin të vendosur nga Administratorja. Në lidhje me këtë të fundit, në vitin 2023, AdmInfo përpiloi një skemë të hollësishme të aseteve fizike dhe elektronike të DHSK-së me qëllim të verifikimit të

integritetit të Regjistrisë të Aseteve të Informacionit të DHSK-së. Njëkohësisht, analiza i dha grupit të punës dhe mbikëqyrësve të aseteve të informacionit të dhëna të vlefshme për sasinë e materialit që mund t'i nënshtrohet arkivimit të përhershëm.

AdmInfo gjithashtu ofroi këshilla dhe mbështetje për zhvillimin e politikave për administrimin e sigurisë së informacionit dhe për përfshirjen në DHSK të praktikave dhe standardeve më të mira të industrisë. Më 2023, u krye një vlerësim i hollësishëm i ndikimit të biznesit me qëllim që të vlerësoheshin ndikimet e mundshme të incidenteve të sigurisë informative mbi DHSK-në. Si rezultat, u përditësua administrimi i rrezikut për sigurinë e informacionit dhe filluan projektet për shtimin e mëtejshëm të sigurisë kibernetike dhe të informacionit në gjithë gjykatën.

Gjithashtu, AdmInfo ndërmori hapa për t'i ndërgjegjësuar edhe më tej punonjësit e brendshëm për sigurinë kibernetike dhe të informacionit, përfshirë edhe nëpërmjet përdorimit të platformës për trajnime mbi sigurinë e informacionit të ofruar nga Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian. Njësia e Administrimit të Informacionit ofroi gjithashtu shërbime bibliotekare dhe mbështetje për hulumtimet e palëve të ndryshme që kanë lidhje me DHSK-në. Në vitin 2023 u rrit numri i kërkesave për libra, artikuj dhe materiale të tjera kërkimore. Gjithsej, nga koleksioni i brendshëm i DHSK-së, ose bashkëpunimi i saj me bibliotekën e Pallatit të Paqes dhe rjetin e saj institucional morën përgjigje 237 kërkesa.



## Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Në vitin 2023, u rrit interesi dhe vëmendja e publikut në Kosovë dhe në vende të tjera për proceset gjyqësore të DHSK-së, duke u bërë arritje gjyqësore të rëndësishme. Aktgjykimi i parë i apelit i DHSK-së në shkurt, hapja e gjykimit të Pjetër Shalës po atë muaj, fillimi i gjykimit Hashim Thaçi dhe të tjerët në prill dhe kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë drejtuar Dhomës së Gjykatës Supreme në maj shtynë Njësinë për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP) që të gjente forma të tjera të reja për t'i bërë proceset e ndërlikuara gjyqësore sa më lehtë të kuptueshme për publikun e gjerë. Kalendar i ngarkuar i seancave gjyqësore, si dhe zhvillimet operative si arrestimi i një të dyshuari në Shqipëri dhe procedurat pasuese të ekstradimit, si dhe katër arrestime të tjera dhe transferimet në objektin e paraburgimit të DHSK-së, sollën si rezultat raportim të përditshëm në media si dhe shumë aspekte të reja që kërkonin shpjegim dhe angazhim me publikun.

Si përgjigje ndaj rritjes së veprimtarive gjyqësore, DHSK-ja e intensifikoi punën me mediat duke vënë në përdorim faqen e saj në internet dhe kanalet e mediave sociale për t'i përçuar publikut materiale informative përkatëse dhe në kohë. Përmes konferencave të përjavshme informative për shtyp dhe tryezave të rumbullakëta e seminareve me gazetarët kosovarë të përgatitura posaçërisht, NJIKP-ja synonte t'iu jepte gazetarëve që ndiqnin proceset gjyqësore të DHSK-së informacion të rëndësishëm dhe trajnim për raportimin që bënin.

Gjatë vitit 2023, përmes programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së, të financuar nga Zvicra, ekipi i NJIKP-së u takua një herë në muaj me komunitete të ndryshme në të katër anët e Kosovës. Gjithashtu, katër videomateriale të prodhuara më 2022 dhe 2023 u transmetuan gjerësisht në të gjitha stacionet televizive kryesore në Kosovë, duke u përgjigjur në pyetjet që bëheshin më shpesh.

Në vazhdim të rifillimit të vizitave fizike në mjediset e DHSK-së më 2022 pas pandemisë, Gjykata u ndesh me një rritje të ndjeshme të vizitave të drejtpërdrejta në vitin 2023. Studentë, gjykatës, juristë dhe të tjerë u mirëpritën në mjediset e DHSK-së ku iu ofrua një përmbledhje e mandatit dhe proceseve gjyqësore në Gjykatë. Gjatë vitit, DHSK-ja mirëpriti 53 grupe, duke përfshirë edhe nga një numër universitetesh në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara.



Veprimtari për komunikim dhe ndërgjegjësim në Koretishtë, Kosovë, tetor 2023

## 2.1 Marrëdhëniet me mediat

Deklaratat hyrëse në gjyqin e Thaçit dhe të tjerëve, nga 3 deri më 5 prill 2023, shënuan rritje të dukshme të interesimit të mediave për DHSK-në. Rreth 50 gazetarë nga 31 kanale të mediave i ndoqën deklaratat hyrëse në mjediset e DHSK-së. Këtu përfshiheshin shtatë kanale mediash nga Kosova, tetë nga rajoni dhe 13 organizata ndërkombëtare lajmesh, mes të cilëve edhe BBC, ARD, Associated Press, Agence France Press dhe Reuters.

Gjatë vitit 2023, DHSK-ja vazhdoi të organizojë informime javore për shtypin të cilat mund të ndiqeshin nga gazetarët drejtpërdrejt ose përmes internetit për t'u përditësuar në lidhje me zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe për të bërë pyetje. Krahas këtyre, NJIKP-ja pati takime me redaktorë lajmesh në Kosovë për të mësuar se si mund të ndihmoheshin gazetarët që pasqyronin procedurat gjyqësore dhe, si rrjedhojë, organizoi edhe tryeza të rrumbullakëta të përshtatura për gazetarët, për t'iu përgjigjur nevojave të shprehura nga përfaqësuesit kosovarë të mediave.

Në maj 2023, DHSK-ja organizoi në Hagë një trajnim dyditor për gazetarët kosovarë. Trajnimi u përqendrua te raportimi i paanshëm dhe objektiv, duke iu dhënë njëkohësisht gazetarëve pjesëmarrës rastin për t'u familjarizuar me mjediset e DHSK-së.



Zëdhënësi i DSHK-së Angela Griep gjatë një interviste me Radio Televizionin e Kosovës, prill 2023



Zëdhënësi i DSHK-së Majkël Dojl gjatë një interviste me Radion Evropa e Lirë, prill 2023

Trajnimi u drejtua nga dy gazetarë ndërkombëtarë të cilët ndanë me të pranishmit njohuritë dhe përvojat e tyre të gjata në raportimin e gjyqimeve të krimeve të luftës, duke përfshirë edhe përvojat në raportimin e proceseve gjyqësore para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe para Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Zëdhënësit e DSHK-së vazhduan t'u përgjigjeshin pyetjeve të mediave brenda 24 orëve nga marrja e tyre. Në vitin 2023 u pranuan dhe morën përgjigje mbi 250 pyetje nga mediat, kryesisht të gazetarëve kosovarë. Zëdhënësit e DSHK-së dhe përfaqësues të tjerë të lartë dhanë 16 intervista për mediat kosovare dhe rajonale. Gjatë vitit, Kryetarja dha dy intervista.



Vizitë e gjykatësve dhe juristëve italianë në DSHK, korrik 2023

## 2.2 Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

Gjatë vitit 2023, falë mbështetjes zemërgjerë të Zvicrës, vazhduan aktivitetet për komunikim dhe ndërgjegjësim me të rinj, studentë nga shkollat e mesme dhe universitete, avokatë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile e qytetarë të tjerë në të gjithë Kosovën. Ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimi pati takime mujore me disa grupe për të shpjeguar procedurat e gjyqeve, për të sqaruar dhe korrigjuar keqkuptimet dhe keqinformimet dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve e dëgjuar shqetësimet e shprehura. Në vitin 2023, vëmendja u përqendrua te studentët e shkollave të mesme dhe universiteteve, që ishin veçanërisht të angazhuar me pyetje dhe shkëmbim mendimesh.

Që prej vitit 2018, ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimi të DHSK-së ka kryer 156 aktivitete, duke kontaktuar drejtpërdrejt 3 500 vetë. Më 2023, ekipi organizoi 23 takime për komunikim dhe ndërgjegjësim, me gjithsej 485 pjesëmarrës në Dobratin, Gjakovë, Gjilan, Gorazhdec, Graçanicë, Koretishtë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Vërboc. Tre prej këtyre takimeve u zhvilluan përmes internetit.

Në këto takime për komunikim dhe ndërgjegjësim, përfaqësues të gjykatës shpjeguan mandatin dhe përbërjen e gjykatës dhe dhanë informacion për çështjet gjyqësore. Aktivitetet u përshtatën për të dhënë informacionin që i nevojitej më shumë pjesëmarrësve në fjalë dhe për të përfshirë pjesëmarrësit në bashkëbisedim dhe diskutim të hapur. Duke nisur nga pyetjet që u përsëritën më shpesh gjatë këtyre takimeve, në kanalën YouTube të DHSK-së u transmetuan videomateriale të cilat u dhanë edhe nga kanalet televizive kosovare. Deri në fund të vitit 2023, DHSK-ja kishte prodhuar 14 videomateriale të cilat u transmetuan mbi 1 100 herë në shqipe dhe në serbishte në 11 kanale të ndryshme televizive të Kosovës dhe u panë me mijëra herë në kanalën e DHSK-së në *YouTube*.

Drejtesit kryesorë të DHSK-së janë të përkushtuar për programin e komunikimit dhe ndërgjegjësimi. Për këtë qëllim, Kryetarja vizitoi Kosovën në nëntor 2023. Gjatë vizitës ajo pati takime për komunikim dhe ndërgjegjësim me gazetarë dhe shoqërinë civile dhe me studentë të universiteteve. Ajo dha dy intervista për mediat dhe u takua me anëtarë të Rrjetit të Informimit të Gjykatës (RRIGJ) në Prishtinë për të dëgjuar mendimet e tyre dhe për të diskutuar për veprimtari të komunikimit dhe ndërgjegjësimi në të ardhmen.



Kryetarja Trendafilova në një veprimtari për komunikim dhe ndërgjegjësim në Prishtinë, Kosovë, nëntor 2023



## 2.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjeti i Informimit të Gjykatës

RRIGJ-ja është një grup i OJQ-ve nga Kosova dhe Serbia me të cilin DHSK-ja është këshilluar rregullisht që nga viti 2017 për mendime dhe këshilla në lidhje me punën e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, përfshirë edhe mënyrën më të mirë për t'u lidhur me audiencat dhe komunitetet e ndryshme për t'i përcjellë audiencave pa përvojë juridike informacion të vlefshëm dhe të kuptueshëm për procese komplekse.



Takim i Administratores me Rrjetin e Informimit të Gjykatës, prill 2023

Në prill 2023, përfaqësues të RRIGJ-së vizituan Hagën për të ndjekur deklaratat hyrëse të çështjes gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, për t'u takuar me Kryetaren dhe Administratoren dhe për t'u angazhuar me NJIKP-në në diskutime për mënyrën se si mund të përshtaten programet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit duke pasur parasysh zhvillimet në proceset gjyqësore të DHSK-së. U mirëpritën komentet për mesazhet kryesore më të reja dhe për videomaterialet më të fundit të prodhuara për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Pas takimit të prillit, NJIKP-ja dhe RRIGJ-ja u takuan edhe dy herë të tjera, një herë nëpërmjet internetit dhe një herë në Prishtinë.



Kryetarja Trendafilova në takim me Rrjetin e Informimit të Gjykatës, prill 2023

## 2.4 DHSK-ja në internet

Faqja e DHSK-së në internet ofron një mori informacionesh për këdo që dëshiron të mësojë për institucionin. Kjo faqe përfshin informacion të hollësishëm për proceset gjyqësore, përditësime të transmetuara drejtpërdrejt që japin zhvillimet më të fundit në proceset gjyqësore, si edhe tabela me fakte, infografikë dhe raporte për DHSK-në. Gjithashtu, faqja në internet mundëson ndjekjen e seancave publike në të tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Gjatë vitit 2023, faqja e transmetimeve të drejtpërdrejta ishte më e vizituara ndër faqet e internetit të DHSK-së, duke marrë gjithsej 130 000 shikime, që është tre herë më shumë krahasuar me vitin 2022. Vetëm transmetimi në internet i deklaratave hyrëse të çështjes gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* tërhoqi 30 000 shikime. Për më tepër, në arkivin e Dokumentacionit Gjyqësor Publik të faqes së DHSK-së në internet mund të gjenden të gjitha vendimet dhe parashtrimet publike, të cilat u japin mundësi njerëzve në të katër anët e botës t'i ndjekin nga afër proceset gjyqësore. Në tërësi, vizitat në faqen e internetit të DHSK-së u rritën 32%, duke arritur një numër rekord prej 950 000 shikimesh më 2023.

Videot informative mbi mandatin, punën dhe proceset gjyqësore të DHSK-së, si edhe pyetjet më të shpeshta mund të gjenden në kanalën e DHSK-së në YouTube. Gjithashtu, në atë kanal transmetohen regjistrime të seancave publike. Gjatë vitit 2023, kanali YouTube i DHSK-së pati 43 000 shikime me gjithsej 3 000 orë. Videoja më e shikuar ishte dita e parë e deklaratave hyrëse në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*.

Duke u përgatitur për fillimin e gjykimit në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, DHSK-ja çeli llogaritë Twitter (tani X) në të tri gjuhët e gjykatës. Përmes këtyre llogarive Gjykata jep përditësime të rregullta mbi proceset gjyqësore dhe informacion mbi mandatin e saj. Deri në fund të vitit 2023, llogaria X kishte 780 ndjekës. Në nëntor 2023 DHSK-ja hapi llogarinë në Instagram, përmes së cilës shpërndan informacion për gjykatën, proceset gjyqësore dhe jep përditësime për programin e komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Në fund të vitit, llogaria e DHSK-së në Instagram kishte 115 ndjekës.





## Kosovo Specialist Chambers & Specialist Prosecutor's Office

The Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office were established pursuant to an international agreement ratified by the Kosovo Assembly, a Constitutional Amendment and the Law on Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office. They are of temporary nature with a specific mandate and jurisdiction over crimes against humanity, war crimes and other crimes under Kosovo law, which were committed or committed in Kosovo between 1 January 1998 and 31 December 2000 by or against citizens of Kosovo or the Federal Republic of Yugoslavia.

The Kosovo Specialist Chambers and the Specialist Prosecutor's Office have a seal in The Hague, the Netherlands. Their staff is international, as are the Judges, the Specialist Prosecutor and the Registrar.

**IN FOCUS**  
**Appeals Panel pronounces judgment in Salih Mustafa case**  
[Read more](#)

**Public court records**  
[Access the database](#)

**Streaming**  
[Streaming site](#)

**NEWS**  
**Specialist Prosecutor welcomes Mustafa appeal verdict as "victory for justice"**  
 Specialist Prosecutor Kimberly Wood welcomed today's judgment in the appeal of Salih Mustafa, who...  
[Read more](#)

**LIVE UPDATE**  
**Kila's (second) appeal against continued detention denied**  
 On 26 February, the Court of Appeals Panel denied the appeal by her lawyer against the latest Single Judge's decision...  
[Read More](#)

**VICTIMS' PARTICIPATION**  
 Victims' coun...  
[Read More](#)

**MUSTAFA: VIDEO OF APPEAL JUDGMENT**  
[Click here to watch](#)

**KSC OUTREACH**  
 FAQ 1 - Jurisd...  
[Read More](#)

**OMBUDSPERSON**  
 The Ombudsp...  
[Read More](#)

**VISITS**  
 The Kosovo Specialist Chambers offers visitors and journalists the possibility to attend public hearings from the gallery of the courtroom. Accredited journalists may also use the media room to work during breaks in closed sessions.  
[Read More](#)

Avokati i Popullit i DHSK-së vepron i pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, pasi ofron një mekanizëm më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

Avokati i Popullit i DHSK-së është Pietro Spera, gjykatës italian, i cili u emërua në këtë post në maj 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit të DHSK-së përshkruhen hollësisht në amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të DHSK-së (Rregullorja) dhe në Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Në vitin 2023, Zyrës së Avokatit të Popullit iu paraqitën shtatë ankesa. Për dy prej këtyre ankesave procesi i shqyrtimit ka përfunduar, tri janë tërhequr, ndërsa dy janë ende në proces shqyrtimi, në pritje të informacioneve shtesë që Avokati i Popullit u ka kërkuar ankuesve.

Njëra prej dy ankesave të shqyrtuara u hodh poshtë nga Avokati i Popullit mbështetur në faktin se as DHSK-ja dhe as ZPS-ja nuk kishin ndërvepruar me ankuesin dhe se ankuesi nuk kishte ngritur pretendime ndaj asnjërës prej tyre. Institucionet të cilat ishin objekt i ankesës ishin jashtë juridiksionit të zyrës së Avokatit të Popullit. Ankesa e dytë u hodh poshtë nga Avokati i Popullit mbështetur në faktin se ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Ankuesve iu komunikua rezultati i ankesave dhe vendimet përkatëse, së bashku me arsyetimin e plotë të vendimit.

Që prej krijimit të saj, në Zyrën e Avokatit të Popullit janë paraqitur gjithsej 29 ankesa dhe për 27 prej tyre shqyrtimi ka përfunduar.

Në vitin 2023, Avokati i Popullit përfundoi dy hetime administrative në lidhje me ankesa të paraqitura në vitin 2022. Versionet e raporteve përfundimtare të konstatimeve të Avokatit të Popullit gjenden në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen e parë (ÇËSHTJA-2022-02), ankesa e bërë nga katër persona të akuzuar para DHSK-së përmbante tetë pika të veçanta. Së pari, ankuesit pretendonin se DHSK-ja vazhdonte të mos respektonte Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Gjithashtu, ata pretendonin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk kishte mbikëqyrje dhe llogaridhënie mbi DHSK-në, dhe se zhvendosja e DHSK-së në një shtet të tretë shkelte të drejtat e tyre themelore. Më tej, ankuesit pretendonin se vonesat në procesin gjyqësor dhe mosrespektimi nga ZPS-ja i detyrimin për nxjerrjen e materialeve përbënin shkelje të të drejtave të tyre themelore. Ankuesit më tej pretendonin se të drejtat e tyre themelore ishin shkelur për shkak të redaktimeve të tepruara të materialeve që u jepen nga ZPS-ja. Gjithashtu, ata ishin të shqetësuar që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte marrë vendim lidhur me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Së fundi, ankuesit pretendonin se DHSK-ja kishte shkelur Ligjin duke mos pasur seli gjyqësore në Kosovë. Avokati i Popullit rrëzoi pikën e parë, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë të ankesës, pasi këto ishin çështje që kishin të bënin drejtpërdrejt me procesin aktual gjyqësor. Për sa i përket pjesës së mbetur të ankesës, Avokati i Popullit hodhi poshtë pretendimet e ankuesve pasi nuk arritën të vërtetonin shkelje të të drejtave të njeriut nga DHSK-ja.

Në çështjen e dytë (ÇËSHTJA-2022-04), ankuesi pretendonte se gjatë intervistës që i bëri ZPS-ja, kur i referoheshin Kosovës, prokurorët intervistues përdornin në mënyrë të përsëritur termin "Kosovo i Metohija" (Kosovë dhe Metohi). Ankuesi pretendonte se përdorimi i këtij termi gjatë intervistës ishte fyes dhe në shkelje të Kushtetutës së Kosovës. Pas shqyrtimit të ankesës, Avokati i Popullit u bind se veprimet e ZPS-së ishin të paqëllimshme dhe të izoluara dhe se ZPS-ja kishte marrë masa për trajtimin e çështjes. Avokati i Popullit pranoi se përdorimi i termit në fjalë ishte fyes për ankuesin. Megjithatë, Avokati i Popullit e hodhi poshtë ankesën pasi nuk vërtetonte se ZPS-ja kishte shkelur të drejtat e njeriut të ankuesit.

Në vitin 2023, Avokati i Popullit publikoi në faqen e internetit të DHSK-së një përmbledhje të të gjitha ankesave të marra. Krahas përmbledhjeve, Avokati i Popullit publikoi të plotë në internet edhe një raport në lidhje me të gjitha ankesat e marra që kishin të bënin me DHSK-në apo me ZPS-në.

Në kuadër të funksionit të tij monitorues, Avokati i Popullit vazhdoi gjatë gjithë vitit angazhimin e tij konstruktiv me DHSK-në dhe ZPS-në, me qëllim garantimin e respektimit të përpiktë të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Në veçanti, Avokati i Popullit vazhdoi bashkëpunimin me Zyrën Administrative dhe Njësinë e Paraburgimit në lidhje me objektin e paraburgimit.

Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit kreu një inspektim fizik të objektit të paraburgimit të DHSK-së, për të siguruar se ai funksiononte në përputhje të plotë me të drejtat e njeriut dhe me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare. Inspektimi u krye në qershor. Gjatë inspektimit, Avokati i Popullit ftoi secilin të paraburgosur që ta informonte, individualisht dhe në takime private. Pas inspektimit, Avokati i Popullit u bind se kushtet e paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHSK-së vazhdojnë të jenë në përputhje të plotë me të drejtat e njeriut dhe me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare. Në tetor, me kërkesë të njërit nga të paraburgosurit, Avokati i Popullit pati një takim në distancë me të.



Avokati i Popullit Pietro Spera

Gjatë gjithë vitit 2023, Zyra e Avokatit të Popullit vazhdoi punën në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim. Me ndihmën e Njesisë për Informim dhe Komunikim të Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në tri aktivitete ndërgjegjësuese me shoqërinë civile në rajon, që u zhvilluan me praninë fizike të pjesëmarrësve.

*Sidoqoftë, ankuesit kanë pasur dhe ende kanë në dispozicion mjete juridike për shqyrtimin e pretendimit konkret të lartpërmendur në lidhje me shkeljen e të drejtave themelore të tyre, siç është referimi në DHSGJK. Lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv, duhet theksuar se fjala "mjet juridik", në kontekstin e nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"), nuk nënkupton një mjet juridik që detyrimisht do të ketë sukses, por thjesht një mjet juridik që mund të përdoret para një autoriteti kompetent për të shqyrtuar themelësinë e një ankese. Neni 13 garanton disponueshmërinë e mjetit juridik por jo rezultatin e suksesshëm. Mundësitë e pakta për sukses, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes, nuk e zvogëlojnë "efektivitetin" e mjetit juridik të paraparë në nenin 13.*

Përmbledhja e njërit prej konstatimeve të Avokatit të Popullit pas shqyrtimit që i bëri një ankese (Çështja 2022-02), lëshuar më 20 shkurt 2023.

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore ofroi mbështetje juridike dhe operative për Gjykatën dhe palët në proceset gjyqësore përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, Njesisë së Përkthimit, Zyrës së Mbrojtjes, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njesisë së Paraburgimit.

Në vitin 2023, DHSK-ja shënoi arritje me shqiptimin e dy aktgjyqimeve të para të apelit dhe fillimin e gjykimit të dy çështjeve. Gjatë periudhës që mbulon ky raport, numri i të paraburgosurve në objektin e paraburgimit

arriti në njëmbëdhjetë pas arrestimit dhe transferimit të katër personave të tjerë. Pas transferimit të dy personave të dënuar në Kosovë, në fund të vitit 2023 në objektin e paraburgimit mbahen në paraburgim dhjetë persona.

Njësitë e ndryshme të Seksionit të Shërbimeve Gjyqësore janë të përfshira në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, përfshirë mbështetjen për dëshmitarët, duke garantuar përfaqësimin e viktimave pjesëmarrëse në proces dhe garantimin e kushteve të sigurta të paraburgimit për të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

## 4.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës

Si përgjegjëse për dokumentacionin e çështjeve gjyqësore, Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) administron përpunimin dhe shpërndarjen e të gjithë dokumentacionit të çështjeve gjyqësore përmes sistemit elektronik *Legal Workflow* të administrimit të Gjykatës në DHSK dhe ka edhe përgjegjësi të tjera në lidhje me administrimin e seancave gjyqësore, ndër të cilat transkriptimin e seancave përmes sistemit elektronik *Transcend*. NJAGJ-ja administron gjithashtu një arkiv fizik të posaçëm të provave materiale.

Në vitin 2023 u mbajtën 137 seanca gjyqësore. NJAGJ-ja përpunoi dhe shpërndau 727 transkripte të këtyre seancave në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës. Nga këto, 321 ishin publike dhe gjenden në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit të DHSK-së. Gjatë 2023-it, NJAGJ-ja mori, përpunoi dhe shpërndau 2 794 parashtime të protokolluara me 1 451 shtojca, gjithsej mbi 73 000 faqe.

Në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik u përfshinë 1 402 parashtime dhe shtojca të klasifikuara si publike. Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave përkatës nga trupat gjyqësore kompetentë për riklasifikimin e 169 parashtimeve si publike, ato u ripërpunuan dhe rishpërndanë si të tilla. Përmes sistemit u përpunuan mbi 5 000 kërkesa për përkthim dhe u dorëzuan mbi 11 000 materiale mes palëve, me sasi 144 gigabajt.

Vazhdoi puna për përmirësimin e sistemit *Legal Workflow*, për t'u ofruar palëve mjetet e nevojshme teknologjike për përmbushjen e nevojave të tyre si dhe për të përmirësuar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit, duke pasur parasysh përdorimin në rritje të tij. Deri në fund të vitit 2023, sistemi kishte gjithsej 347 përdorues, nga të cilët 100 përdorues të rinj, të cilëve u ofruan trajnime fillestare dhe të përparuara për përdorimin e *Legal Workflow*. Gjithashtu, Njësia mbështeti 272 përdorues të programit kompjuterik të transkriptimit *Transcend*, që mundëson leximin në kohë reale të tekstit të plotë të seancave gjyqësore.

**Në vitin 2023, NJAGJ-ja përpunoi mbi 73 000 faqe parashtime përmes sistemit të posaçëm elektronik të administrimit të gjykatës.**

## 4.2 Njësia e Përkthimit

Në vitin 2023, Njësia e Përkthimit vazhdoi të bëjë përkthime me gojë dhe me shkrim si në selinë e gjykatës, ashtu edhe në kuadër të misioneve.

Gjatë këtij viti, NJP-ja përktheu më se 10 300 faqe në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte, si dhe në gjuhë të tjera, në shërbim të efektivitetit të punës, funksionimit të papenguar të gjykatës dhe komunikimeve të jashtme të saj. Krahas përkthimit të një numri të madh parashtrimesh, NJP-ja ka përkthyer po ashtu informimet javore për mediat, njoftimet për shtyp dhe materiale të tjera informuese dhe ndërgjegjësuese, udhëzues pune, raporte të Avokatit të Popullit, kërkesa të viktimave, dhe korrespondencën me palë të jashtme. Ndër arritjet kryesore të Njesisë së Përkthimit kanë qenë përkthimet e aktgjykimit të trupit gjykues dhe aktgjykimit të apelit në çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj*, si dhe aktgjykimin dhe urdhrin për zhdëmtim në çështjen gjyqësore *Mustafa*.

Gjatë vitit 2023, NJP-ja ofroi shërbime të përkthimit simultan për 137 seanca gjyqësore në faza të ndryshme të proceseve, përfshirë fazën paraprake, të gjykitimit dhe të apelit. Njësia ofroi gjithashtu dhe përkthimin simultan për 46 informime javore për median si dhe shërbime përkthimi simultan dhe konsektiv në takimet dhe mbledhjet e mbajtura në selinë e DHSK-së dhe gjatë misioneve jashtë vendit. Krahas kësaj, NJP-ja u ofroi mbështetje njësive të tjera në lidhje me kërkesat *ad hoc* për shërbime përkthimi me gojë, shkrim apo ndihmë tjetër gjuhësore.

Pas punës së gjerë kërkimore në tregun e shërbimeve të përkthimit gjatë viteve 2021 dhe 2022 për evidentimin dhe testimin e profesionistëve të fushës me njohuri dhe përvojën e duhur gjuhësore, Njësia e Përkthimit vazhdoi përpjekjet për rekrutim dhe trajnim të kandidatëve të mundshëm. Kjo dëshmon për angazhimin e DHSK-së në përmirësimin e vazhdueshëm të punës dhe kontribuon në kuadrin e profesionistëve të kualifikuar të kësaj fushe.

Gjithashtu, përkthyesit e NJP-së morën pjesë në një trajnim pesëditor të ofruar nga Komisioni Evropian për trajnerët e përkthimit me gojë, dhe si rrjedhim, kur nuk janë duke përkthyer, mund të trajnojnë stafin tjetër shqipfolës në DHSK në lidhje me aftësitë themelore të përkthimit me gojë konsektiv dhe ndërlidhës. Stafi i NJP-së ka ndihmuar edhe në testimin e përkthyesve me gojë shqiptarë për Akreditim në Bashkimin Evropian.



Gjatë vitit 2023, NJP-ja përktheu mbi 890 dokumente në gjuhët zyrtare të gjykatës dhe në gjuhë të tjera, sipas kërkesave.

## 4.3 Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të cilët nuk zotërojnë ose zotërojnë pjesërisht mjete financiare, duke garantuar respektimin e parimeve të gjyqimit të drejtë.

Sistemi i ndihmës juridike në DHSK u ofrohet të dyshuarve dhe të akuzuarve të cilët provojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë përfaqësimin juridik dhe nuk marrin ndihmë juridike në mënyra të tjera. Që nga nëntori i vitit 2021, asnjë nga të akuzuarit nuk ka marrë ndihmë juridike nga DHSK-ja, pasi kanë zgjedhur që për këtë qëllim të marrin fonde nga qeveria e Kosovës.

Si pjesë e detyrës për sigurimin e përfaqësimit juridik, ZM-ja, së bashku me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, administron Listën e Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit në DHSK. Në fund të vitit 2023, në këtë listë ishin pranuar 238 avokatë mbrojtës. Prej tyre, 124 ishin regjistruar si mbrojtës të specializuar, 29 si mbrojtës të viktimave dhe 85 plotësonin kriteret për të ushtruar profesionin edhe si mbrojtës të specializuar, edhe si mbrojtës të viktimave. Procesi i paraqitjes së kërkesave për praninë në Listë vazhdon të jetë i hapur.

Si njësi e Zyrës Administrative, ZM-ja është e paanshme dhe nuk ka asnjë rol në procedimin konkret të çështjeve gjyqësore në DHSK. Ajo është pika e kontaktit për çdo problem, pyetje apo çështje të natyrës administrative që mund të kenë ekipet e Mbrojtjes.

Deri në fund të vitit, kishte 12 ekipe të Mbrojtjes, me personel gjithsej 131 persona, përfshirë 12 mbrojtës të specializuar. Njësia u ka dhënë udhëzime ekipeve të Mbrojtjes për një sërë çështjesh, ku përfshihen pranimit i anëtarëve në ekipet e Mbrojtjes në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit, regjistrimi në Ministrinë Holandeze të Punëve të Jashtme, qasja në mjedise për zyra, kalimi në sistemet e teknologjisë së informacionit të DHSK-së dhe qasja në sistemin *Legal Workflow*. Për këtë, ZM-ja kontakton njësitë përkatëse të Zyrës Administrative dhe u siguron mbrojtësve të specializuar dhe ekipeve të tyre qasje të plotë në të gjitha shërbimet e ofruara për ta nga DHSK-ja.

Kjo njësi lehtëson komunikimin ndërmjet ekipeve të Mbrojtjes dhe shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera, në lidhje me kërkesat hetimore të ekipeve të Mbrojtjes. Në vitin 2023, u mbështetën 19 lehtësime të tilla. Në rast nevojë, ZM-ja siguron gjithashtu qasje në shërbimet e Mbrojtësit Kujdestar gjatë procedurave ligjore.

**DHSK-ja ofron ndihmë juridike për të dyshuar dhe të akuzuar që nuk zotërojnë mjete financiare, por asnjë nga të paraburgosurit e DHSK-së nuk e ka kërkuar këtë ndihmë.**





## 4.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në DHSK duke u ofruar ndihmë personave që dëshirojnë të marrin pjesë në proces si viktimat, duke përpunuar kërkesat e tyre në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale dhe duke ua dorëzuar ato trupit gjykues përkatës për të marrë vendim në lidhje me to.

Pas pranimit si viktimat pjesëmarrëse në proceset para DHSK-së, ZPV-ja u siguron atyre përfaqësimin e duhur. Për këtë qëllim, ZPV-ja zotëron një listë të mbrojtësve, e cila, në fund të vitit 2023, numëronte 114 mbrojtës të pranuar për të përfaqësuar viktimat në proceset e DHSK-së. ZPV-ja administron gjithashtu sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse.

Viktimat që marrin pjesë në proceset gjyqësore gëzojnë disa të drejta, ndër të cilat të drejtat për njoftim, pranim dhe zhdëmtim. Ato i ushtrojnë këto të drejta përmes Mbrojtësit të viktimave, i cili caktohet për një grup viktimash në secilën çështje gjyqësore. Mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore, të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim ndërsa i mban viktimat të informuara gjatë gjithë procesit për zhvillimet që prekin të drejtat dhe interesat e tyre. Mbrojtësi i viktimave merr mendimet e viktimave, dëgjon shqetësimet e tyre dhe i sjell ato në vëmendje të gjykatësve.

ZPV-ja ka marrë 316 aplikime dhe ka dorëzuar 21 raporte pranë trupave gjykues përkatës. Gjatë vitit 2023, me fillimin e gjykimit në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët, pati një rritje të konsiderueshme të numrit të viktimave pjesëmarrëse. Që prej vitit 2020, statusi i viktimës pjesëmarrëse iu është miratuar 157 personave në tri çështje gjyqësore.

Statusi i viktimës pjesëmarrëse është miratuar për tetë persona në çështjen gjyqësore kundër z. Shala, tetë në çështjen gjyqësore kundër z. Mustafa dhe 141 persona në çështjen gjyqësore kundër Thaçit dhe të tjerëve. Me ecurinë e gjykimeve, afatet përkatëse për aplikime kanë përfunduar.

Gjithashtu, statusi i viktimës pjesëmarrëse iu refuzua 120 personave në çështjen Thaçi dhe të tjerët me argumentin se ishin jashtë fushëveprimit gjeografik, kohor apo material të Aktakuzës. ZPV-ja u siguroi që personat e refuzuar të merrnin këshillat dhe përfaqësimin e duhur ligjor në lidhje me mundësinë për apelim. Si rrjedhojë, u parashtruan katër apeline, të cilat u refuzuan të gjitha.

Së fundi, pas Aktgjykimit, Trupi Gjykues në çështjen kundër z. Mustafa lëshoi një urdhër për zhdëmtim. Ky ishte i pari urdhër i tillë në DHSK. Në këtë urdhër, Trupi Gjykues konstatoi se modaliteti më i përshtatshëm për zhdëmtimin e tetë personave ishte kompensimi monetar individual dhe urdhëroi z. Mustafa të paguajë shumën prej 207 000 eurosh si kompensim për dëmin e shkaktuar. Megjithatë, Trupi Gjykues vuri në dukje gjithashtu se z. Mustafa aktualisht nuk ka mjete financiare për të përmbushur plotësisht urdhrin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues theksoi se për zbatimin e urdhrin duhet të përfshihen aktorë të tjerë, veçanërisht në Kosovë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues bëri me dije se Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve që ekziston në Kosovë mund të jetë një mundësi për zbatimin e urdhrin për zhdëmtim dhe e ftoi Kosovën të krijojë një mekanizëm për zhdëmtimin e viktimave të krimeve brenda juridiksionit të DHSK-së. Së fundi, Trupi Gjykues rekomandoi krijimin e një fondi të ri për viktimat e krimeve brenda juridiksionit të DHSK-së, në rast se Kosova nuk i përmbush brenda një kohe të arsyeshme detyrimet që ka ndaj viktimave.

**Që prej vitit 2020, statusi i viktimës pjesëmarrëse u është miratuar 157 personave para DHSK-së.**

## 4.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore.

Në vitin 2023, ZMMD-ja mundësoi paraqitjen e sigurt dhe në kohë të 60 dëshmitarëve para DHSK-së. Prej 60 dëshmitarëve, 21 dëshmuan në gjykimin e Shalës, përfshirë gjashtë dëshmitarë ekspertë, dhe 39 ishin dëshmitarë të Prokurorisë që dëshmuan në çështjen gjyqësore Taçi dhe të tjerët. Dëshmitarëve iu ofrua mbështetje, mbrojtje dhe ndihmë tjetër e përshtatshme dhe e nevojshme për dhënien e dëshmive.

Në bashkëpunim me palët thirrëse, ZMMD-ja planifikoi, organizoi dhe bashkërendoi logjistikën e nevojshme për paraqitjen e dëshmitarëve në Gjykatë, dhe mundësoi ardhjen e tyre të sigurt nga vendbanimi për në vendin e dhënies së dëshmisë, me mbështetje, nëse ishte e nevojshme, të shtetit pritës dhe autoriteteve të tjera përkatëse. Prej 60 dëshmitarëve që u paraqitën para DHSK-së në vitin 2023, tetë dëshmuan përmes videolidhjes dhe për 33 dëshmitarë që u paraqitën në sallën e gjyqit u morën masa mbrojtëse. Në të gjitha rastet, ZMMD-ja bëri vlerësimin e nevojave individuale dhe u dha dëshmitarëve informacion të hollësishëm për paraqitjen e tyre në Gjykatë në mënyrë që të ishin të përgatitur. Në bazë të këtyre vlerësimeve, dëshmitarët u shoqëruan nga stafi i ZMMD-së dhe/ose për ta u morën masa sigurie shtesë. Në vitin 2023, personeli i ZMMD-së kreu gjithsej 54 misione për shoqërimin e dëshmitarëve.

Për të mundësuar dhënien e dëshmisë dhe pakësuar rrezikun e traumave të përsëritura, dëshmitarët vlerësohen para, gjatë dhe pas dëshmisë. Këto vlerësime janë individuale dhe në bazë të tyre mund të ofrohet ndihmë mjekësore. Krahas tyre, me miratimin e dëshmitarëve, mund të bëhen vlerësime psikologjike nga psikologë të specializuar të ZMMD-së në mënyrë që të jepet mbështetja dhe ndihma e përshtatshme psikosociale para dhe gjatë dëshmisë, përfshirë rekomandimin e masave të veçanta ose mbrojtëse në sallën e gjyqit për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve të cenusshëm dhe për të mbrojtur dinjitetin dhe privatësinë e tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Një numër dëshmitarësh që dëshmuan në vitin 2023, përfshirë ata që dëshmuan me status të dyfishtë si viktima-dëshmitarë, u vlerësuan si të cenusshëm dhe përfituan masa të veçanta në sallën e gjyqit, të dhëna nga trupi gjykues përkatës pas rekomandimit të ZMMD-së.

ZMMD-ja trajtoi gjithashtu nevojat e sigurisë të dëshmitarëve që përfunduan dëshminë, kur ishte e përshtatshme në bashkëpunim me palën thirrëse, dhe u ofroi mbrojtje dëshmitarëve dhe familjeve për të cilët u vlerësua se përballeshin me nivel të lartë rreziku për shkak të dëshmive të tyre. Me kërkesë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, njësisë u ofroi masa mbrojtëse të gjithë dëshmitarëve të rrezikuar të paraqitur para DHSK-së, si dhe viktimave dhe personave mbështetës shoqëruar, gjatë gjithë procesit të gjyqimit. ZMMD-ja vazhdoi bashkëpunimin e ngushtë me shtetin pritës dhe partnerët e tjerë për zbatimin e masave të përshtatshme për të garantuar sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve që u paraqitën para DHSK-së.

**Në vitin 2023, ZMMD-ja mundësoi paraqitjen e sigurt dhe në kohë të 60 dëshmitarëve para DHSK-së.**

## 4.6 Njësia e Paraburgimit

Njësia e Paraburgimit (NJP) drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet në mjediset e një burgu holandez në Hagë.

Njësia e Paraburgimit siguron që të paraburgosurit të jenë të mbrojtur dhe të sigurt dhe garanton respektimin e plotë të dinjitetit dhe të drejtave të tyre në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit të DHSK-së, rregulloret, standardet ndërkombëtare përkatëse dhe praktikat më të mira. Gjatë vitit 2023, tre të akuzuar dhe një i dyshuar u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Pas lirimit me kusht në Kosovë të z. Gucati në tetor dhe të z. Haradinaj në dhjetor, në fund të vitit 2023, në objektin e paraburgimit të DHSK-së ishin dhjetë të paraburgosur.

DHSK-ja është e angazhuar t'u sigurojë të paraburgosurve kohën dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre. Në përputhje me këtë angazhim dhe me fillimin e proceseve të gjyqësorit për dy çështje të tjera, NJP-ja autorizoi vizita personale dhe nëpërmjet videolidhjes jashtë orarit të rregullt të vizitave. Kjo u bë për të paraburgosurit që, për shkak të fillimit të fazës së gjyqësorit, nuk ishin takuar me mbrojtësit e tyre gjatë orarit të rregullt zyrtar. Njësia vazhdoi t'u mundësojë të paraburgosurve marrjen pjesë në procesin e gjyqësorit nga distanca prej objektit të paraburgimit, me kërkesë dhe autorizim të trupit gjyqësor përkatës.

NJP-ja synon vënien në dispozicion të të paraburgosurve mjete të arsyeshme për ruajtjen e marrëdhënieve personale me anëtarët e familjes dhe persona të tjerë përmes vizitave.

Vizitat nëpërmjet videolidhjes, të vëna në zbatim si nevojë gjatë pandemisë, mbetën edhe gjatë vitit 2023 një alternativë për të paraburgosurit.

Në dhjetor 2023, Trupi Gjyqësor në çështjen Thaçi dhe të tjerët urdhëroi disa kufizime për vizitat, komunikimet telefonike dhe korrespondencën e tre prej të akuzuarve të kësaj çështjeje. Për rrjedhojë, NJP-ja e shtoi mbikëqyrjen aktive dhe vuri në funksion një sistem vlerësimi në pajtim me vendimin e Trupit Gjyqësor. Këto masa shtesë u vlerësuan të nevojshme për sigurimin e integritetit të procesit gjyqësor dhe në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit.

Në vitin 2023, të paraburgosurve iu ofruan aktivitete të përmirësuara për kohën e lirë. Palestra u rinovua dhe u pajis me pajisje të reja sportive, një instruktor sporti dha ndihmë individuale dhe vazhduan të ofroheshin kurset e gjuhës angleze.

Për sa i përket shërbimeve mjekësore, të paraburgosurit vazhduan të përfitojnë nga standardet më të larta të kujdesit shëndetësor, me qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor për të siguruar vazhdimin e trajtimit dhe kujdesit.

Në vitin 2023, Avokati i Popullit zhvilloi inspektimin e katërt fizik për vlerësimin e kushteve të paraburgimit, në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Në nëntor 2023, një delegacion i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) vizitoi objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe takoi ata të paraburgosur që dëshironin të takoheshin me ta. DHSK-ja e mirëpret fuqimisht mbikëqyrjen e jashtme që ofroi kjo vizitë.

Gjatë vitit 2023, NJP-ja administroi mbi 1 000 vizita personale nga familjarët dhe vizitorë të tjerë në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore, Njesisë së Teknologjisë së Informacionit, Njesisë për Administrimin e Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme, Njesisë së Sigurisë, Njesisë së Financave dhe Buxhetit dhe Njesisë së Prokurimit.

Në vitin 2023, puna e seksionit u përqendrua në lehtësimin e procedurave gjyqësore, përfshirë mundësimin e aktiviteteve në sallën e gjyqit, mbështetjen për zbatimin e sistemit elektronik të administrimit të Gjykatës *Legal Workflow* dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake dhe të Trupit Gjyqësor. Për këtë qëllim, Njësia e Sigurisë transferoi me sukses tre të akuzuar të tjerë dhe një të dyshuar në objektin e paraburgimit të DHSK-së, organizoi tri vizita për arsye humanitare të personave të paraburgosur në Kosovë dhe transferoi dy persona të dënuar në Kosovë pas modifikimit të dënimeve të tyre.

Gjatë vitit 2023, si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të DHSK-së për miradministrimin e burimeve njerëzore dhe financiare, shefi i Seksionit të Administratës dhe shefi i Njesisë së Financave dhe Buxhetit organizuan trajnime të fokusuar në të gjithë DHSK-në për përmirësimin më tej të përdorimit efektiv të burimeve dhe për të siguruar zbatimin e rreptë të buxhetit të DHSK-së.

Shefi i Seksionit të Administratës të DHSK-së, në cilësinë e personit të kontaktit kundër mashtrimeve, së bashku me audituesen e brendshme dhe një punonjës të Seksionit të Administratës, zbatuan planin e veprimit të DHSK-së kundër mashtrimit dhe organizuan trajnime ndërgjegjësuese kundër mashtrimit për punonjësit. Në vitin 2023, 96 për qind e personave në pozita kyçe në DHSK dhe ZPS kryen trajnimin rinfreskues vjetor.

## 5.1 Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NBJNJ) ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. NBJNJ-ja vazhdoi kryerjen e detyrave të saj përmes ofrimit të ndihmës në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve, administrimit dhe këshillimit të tyre për një sërë çështjesh të personelit – që nga kompensimet dhe përfitimet, deri tek aspekte të mirëqenies dhe sigurimit shëndetësor; ofrimit të mbështetjes për punonjësit dhe drejtuesit gjatë procesit të rinovimit të kontratave, vlerësimit të punës së punonjësve dhe ofrimit të mundësive për zhvillimin profesional dhe të njohurive të punonjësve.

Në vitin 2023 u mbyllën dy ftesa për aplikime për vende pune dhe dy ftesa për praktikë profesionale. Për ftesat për vende pune, u dorëzuan gjithsej 2 950 aplikime nga 1 256 aplikantë.

Prej tyre, 554 ishin femra dhe 699 meshkuj, dhe 90% ishin nga shtete anëtare të BE-së dhe 10% nga shtete të treta kontribuuese. Gjatë vitit u morën 43 aplikime gjithsej për kandidatë të emëruar prej autoriteteve shtetërore. Ftesat për praktikë profesionale sollën 555 aplikime nga 196 aplikantë, prej të cilëve 147 ishin femra dhe 49 meshkuj.

Në vitin 2023, filluan punë 44 punonjës të rinj, prej të cilëve 19 femra dhe 25 meshkuj. Gjithashtu DHSK-së iu bashkuan 15 praktikantë, prej të cilëve 13 femra dhe dy meshkuj. Personeli i gjithsejtë i DHSK-së dhe ZPS-së u rrit nga 276 më 31 dhjetor 2022 në 283 më 31 dhjetor 2023. Prej 205 punonjësve në DHSK, 99 ishin femra dhe 106 ishin meshkuj, dhe nga 78 punonjës në ZPS, 34 ishin femra dhe 44 meshkuj.

Numri i punonjësve të emëruar për punësim nga shtetet anëtare arriti në vitin 2023 nga 11 në 12, me tetë punonjës të emëruar nga katër vende anëtare të BE-së (Bullgaria, Gjermania, Hungaria dhe Irlanda) ndërsa dy shtete të treta kontribuuese (Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) emëruan tre punonjës dhe Prokurorin e Specializuar.

NJBNJ-ja vazhdoi mbështetjen e nevojave organizative duke punësuar kandidatë cilësorë për t'iu përgjigjur kërkesave operative dhe duke synuar përfaqësimin e baraspeshuar gjinor dhe regjional. Gjithashtu, në bazë të kompetencave të Administratores dhe për t'iu përgjigjur nevojave për administrimin efikas të burimeve njerëzore dhe për caktimin e punonjësve në përputhje me kërkesat e ngarkesës së punës, në vitin 2023 u miratuan disa caktime të përkohshme në detyrë.

NJBNJ-ja vazhdoi të ofrojë takime informuese për fillestarë për punonjësit, mundësi për zhvillimin profesional dhe të njohurive me tema si drejtimi dhe administrimi, administrimi i punës, barazia, diversiteti dhe gjithëpërfshirja, trajnime teknike të specializuara, kurse për mësimin e shqipes dhe serbishtes, si dhe qasje në rrjetin e mësimin digjital.

Me mbështetjen e vazhdueshme të drejtuesve të lartë të DHSK-së dhe ZPS-së për të siguruar një mjedis pune të sigurt, në frymë respekti dhe pa asnjë formë ngacmimi, NJBNJ-ja u siguroi që punonjësit e rinj të ndiqnin trajnime për parandalimin e ngacmimeve psikologjike dhe seksuale.


Gjithashtu, me miratimin e Udhëzuesit kundër Ngacmimit të DHSK-së dhe ZPS-së në dhjetor 2022, NJBNJ-ja organizoi trajnime mbi Udhëzuesin për punonjësit, praktikantët dhe kontraktuesit. Shtatë sesionet e ofruara mundësuan trajnimin e 95% të punonjësve. Krahas kësaj, u krijua një faqe e dedikuar në intranet, e cila jep informacion mbi Udhëzuesin dhe trajnimet e disponueshme.

Për të promovuar një mjedis mbështetës në punë, ku është themelore siguria dhe mirëqenia psikologjike, u zhvilluan trajnime me temat 'Krijimi i një Mjedis Pune Psikologjikisht të Sigurt' dhe 'Kultivimi i Sigurisë Psikologjike'. NJBNJ-ja mbështeti edhe personin e kontaktit për çështjet gjinore në organizimin e një programi intensiv trajnime gjashtëjavor për punonjëset femra mbi zhvillimin e aftësive drejtuese. Këto trajnime të posaçme u ndoqën nga 13 punonjëse femra të organizatës dhe përforcuan më tej angazhimin për të promovuar drejtueset femra në organizatë.

Në vitin 2023, u nis një program i krijuar për t'i kontribuar shëndetit mendor, forcuar qëndrueshmërinë dhe përmirësuar mirëqenien e përgjithshme. NJBNJ-ja organizoi dy fjalime gjatë drekës për tema përkatëse dhe e zhvilloi më tej faqen e posaçme të intranetit.




## Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së



# Përfaqësimi i punonjësve në DHSK dhe ZPS sipas shteteve

31 dhjetor 2023



## 5.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit

Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) mbështeti me shërbime 134 ditë seancash hibride në sallën e gjyqit, gjatë të cilave u krijuan dhe përpunuan 15 000 materiale audiovizuale me 15 terabajt të dhëna në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës. Në seancat hibride u përfshinë pjesëmarrës të pranishëm në sallën e gjyqimit dhe pjesëmarrës në distancë duke përdorur pajisje të sigurta për videolidhje. Krahas aktiviteteve në sallën e gjyqit, NJTI-ja ofroi mbështetje teknike edhe për aktivitete të ndryshme në mjediset e DHSK-së dhe përgatiti materiale audiovizuale për botim në kanalin e DHSK-së në *YouTube*.

Aplikacioni kryesor që përdoret në DHSK është sistemi elektronik i administrimit gjyqësor *Legal Workflow*. Ky sistem përpunon të gjitha vendimet, parashtrimet dhe komunikimet në lidhje me to. Është në përdorim edhe gjatë seancave gjyqësore edhe jashtë tyre, si edhe jashtë orarit zyrtar të punës, për të ndihmuar palët të respektojnë afatet e caktuara nga gjykatësi.

Në vitin 2023, një pjesë e mirë e punës së njësisë u përqendrua në përgatitjen e përmirësimit të ekosistemit *Legal Workflow*, që përfshiu një sërë platformash, aplikimesh, biblioteka të dhënash digjitale dhe kodesh të posaçme, për të siguruar që versioni i ri të jetë i përshtatshëm për punë deri në fund të ciklit të DHSK-së.

Sektori i Shërbimeve i NJTI-së ofroi mbështetje për rreth 500 përdorues, përfshirë palët në proceset gjyqësore dhe shërbimet mbështetëse gjyqësore në DHSK. Sektori i Shërbimeve siguroi gjithashtu përmirësimin, zëvendësimin dhe heqjen nga përdorimi të pajisjeve të përdoruesve fundorë, në bazë të masës së përdorimit aktual dhe atij të parashikuar.

Pas rinovimit të pajisjeve kryesore kompjuterike, të nisur në vitin 2022, njësia zbatoi dhe instaloi pajisje të reja gjatë vitit 2023 për të shmangur nevojën e zëvendësimit të pajisjeve më vonë. NJTI-ja nisi gjithashtu edhe përdorimin e shërbimeve të ruajtjes digjitale të të dhënave (*cloud*) duke ndjekur standardet e tregut. Paralelisht, NJTI-ja forcoi infrastrukturën dhe proceset e sigurisë informatike në mjediset e gjykatës, në sistemet celulare dhe ato për shërbimet e ruajtjes digjitale të të dhënave.

Viti 2023 iu dedikua përgatitjes për një rinovim madhor të ekosistemit *Legal Workflow*, duke e sjellë në teknologjinë e sotme me qëllim krijimin e versionit përfundimtar të këtij sistemi.





## 5.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për administrimin efikas dhe të efektshëm të mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, për të siguruar një mjedis pune cilësor për punonjësit dhe vizitorët. Ndër të tjera, ajo ofron shërbime mbështetëse në lidhje me administrimin e pasurive të paluajtshme në konsultim me autoritetet përkatëse të shtetit pritës, mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ndërtimet, si dhe planifikimin e hapësirave të brendshme.

Njësia kryen edhe shërbime si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastrimi, si dhe administron shërbimin e protokollit, postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin, udhëtimet dhe logjistikën, për të cilat bashkëpunon me Njësinë e Sigurisë dhe Protokollin. Njësia bashkëpunon gjithashtu edhe me EULEX-in për administrimin e objekteve të përdorura nga DHSK-ja dhe ZPS-ja në Prishtinë, Kosovë.

Në vitin 2023, pas nënshkrimit me vendin pritës një vit më herët të kontratës së re për mirëmbajtjen e mjediseve, NJAOSHP-ja mbikëqyri 19 projekte për optimizimin e ambienteve sipas nevojave operative. Një projekt madhor i vitit 2023 ishte transferimi i sistemit të sigurisë informatike, që përfshiu zëvendësimin e të gjithë serverëve të sistemit të sigurisë dhe përditësimin e të gjitha programeve kompjuterike. Për shkak të punës së përditshme, dhe për të mbajtur në funksion sistemin e sigurisë, fazat e fundit të projektit u zbatuan jashtë orarit zyrtar të punës, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurisë.

**Gjatë vitit 2023, NJAOSHP-ja mbikëqyri 19 projekte për optimizimin e ambienteve sipas nevojave operative.**

## 5.4 Njësia e Sigurisë

Njësia e Sigurisë (NJS) kryen një varg shërbimesh në fushën e sigurisë në mbështetje të veprimtarisë së DHSK-së dhe punonjësve. Kjo përfshin ndërgjegjësimin e punonjësve për një sërë rreziqesh në nivel individual dhe organizativ.

Me fillimin e gjyqimit Thaçi dhe të tjerët në prill 2023, NJS-ja vuri në zbatim plane dhe procedura, deri atëherë thjesht konceptuale, për mbështetjen e aktiviteteve gjyqësore për çështjet me disa të akuzuar, dhe kërkesa operative arriti kapacitet të plotë. Për të përballuar këtë kërkesë, NJS-ja përmirësoi planifikimin efektiv të burimeve njerëzore, duke u përqendruar te periudhat kur kërkesa për shërbim ishte më e ulët dhe shfrytëzoi ndryshimet e kalendarit të seancave gjyqësore për të mundësuar marrjet e pushimeve dhe trajnimet e detyrueshme.

Njësia vazhdoi të ofrojë mbështetje për një sërë detyrash operative, disa prej tyre *ad hoc*, si transferimi i katër personave të arrestuar në Holandë, vizitat e të paraburgosurve nën ruajtje në Kosovë dhe aktivitete të tjera sensitive gjyqësore jashtë selisë së DHSK-së. Gjithashtu, dy persona të shpallur fajtorë, pas modifikimit të dënimit u transferuan në Kosovë për të siguruar lirimin e tyre, me disa kushte, për pjesën e mbetur të dënimit. Kryerja e sigurt e këtyre detyrave varet nga mbështetja e agjencive të jashtme, me të cilat është siguruar një marrëdhënie efektive pune në të gjitha nivelet.

Shtimi i aktiviteteve operative nuk i ka ulur përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e kontrolleve administrative dhe procedurale në lidhje me sigurinë.

Në veçanti, për vitin 2023 u përmirësua administrimi i emergjencave me zbatimin e kontrolleve më të rrepta të udhëtimeve private dhe publike të punonjësve. Aftësia e njësisë për të identifikuar punonjësit në shtetin pritës u arrit duke zbatuar rregulla të reja, të cilat u kërkojnë punonjësve të informojnë Njësinë për planet e udhëtimeve, duke krijuar një portal të posaçëm për raportimin e tyre.

Bashkë me instrumentet aktuale të administrimit të emergjencave, është përmirësuar mjaft aftësia e DHSK-së për të konfirmuar nëse punonjësit përfshihen në incidente me shumë viktime në vendin pritës.

Bashkë me NJAOSHP-në, gjatë gjysmës së dytë të vitit, NJS-ja kreu rinovimin e sistemit të administrimit të sigurisë në mjediset e Gjykatës.

**Aftësia e vazhdueshme për identifikimin në çdo kohë të punonjësve në vendin pritës u arrit me vënien në punë të një portali të posaçëm raportimi dhe zbatimin e rregullave përkatëse.**

## 5.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren në administrimin financiar të fondeve që i janë akorduar DHSK-së për zbatimin e mandatit të saj, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe parimet e rregulloreve financiare të BE-së.

Gjatë vitit 2023, NJFB-ja vazhdoi të luajë një rol kyç për ciklin financiar, me qëllim miradministrimin financiar të fondeve. Për sa i përket kornizës rregullatore, gjatë këtij viti u përditësuan një direktivë administrative dhe tri udhëzime operative në lidhje me proceset me ndikim financiar. Njësia u përfshi edhe në hartimin e rregullave shtesë, duke ofruar ekspertizë dhe këshilla gjatë hartimit të tyre. Për të përmirësuar më tej procedurat dhe njohuritë, NJFB-ja organizoi rregullisht trajnime të brendshme për punonjësit lidhur me aspektet kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Aktiviteti kryesor për vitin 2023 ishte procesi i miratimit të buxhetit për Kontratën e Gjashtë për Subvencionim të nënshkruar nga Administratorja, në emër të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe Komisionit Evropian, si donator i subvencionit.

Procesi u mbyll me sukses me miratimin e buxhetit prej 97 100 000 eurosh për periudhën 15 qershor 2023 – 14 qershor 2025. NJFB-ja punoi me Komisionin Evropian për pagesën e shpejtë të kështit të parë, i cili u mor në qershor 2023. Krahas saj, DHSK-ja administroi fonde në përputhje me Kontratën e Pestë për Subvencionim, që u nënshkrua nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe Komisioni Evropian, për periudhën dyvjeçare 15 qershor 2021 – 14 qershor 2023, në shumën prej 103 279 698 euro. Krahas fondeve të akorduara nga BE-ja, DHSK-ja administroi edhe shumën prej 147 000 euro, të akorduar nga qeveria zvicerane për aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere të DHSK-së në vitet 2022 dhe 2023.

Në vitin 2023, NJFB-ja kreu më shumë se 4 000 veprime financiare në kuadër të angazhimeve buxhetore për pagesat. Gjatë vitit 2023, u dorëzuan raporti përfundimtar i Marrëveshjes së Pestë për Subvencionim nga BE-ja për periudhën 15 qershor 2021 – 14 qershor 2023, si dhe raporti i punës për Marrëveshjen për Subvencionim nga qeveria zvicerane për aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere të DHSK-së për vitin 2022.

Llogaritë financiare të DHSK-së u nënshtrohen rregullisht auditimeve të pavarura dhe verifikimeve të shpenzimeve, të kryera nga auditues të brendshëm dhe të jashtëm, siç kërkohet nga Komisioni Evropian dhe korniza rregullatore e DHSK-së. Në vitin 2023, auditimet dhe verifikimet e shpenzimeve të kryera nuk konstatuan asnjë parregullsi. NJFB-ja mbajti një bashkëpunim efektiv me Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) me qëllim monitorimin dhe zbatimin me efektivitet të burimeve financiare të DHSK-së.

Deri në fund të vitit 2023 u kryen 18 auditime të jashtme të DHSK-së, të cilat nuk konstatuan asnjë shkelje.

## 5.6 Njësia e Prokurimit

Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për prokurimet e DHSK-së dhe ZPS-së dhe për kontraktimin e furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve, duke siguruar në kohë dhe me çmimin e duhur mallrat, shërbimet apo punimet e nevojshme për përmbushjen e mandatit të Gjykatës.

Gjithashtu, njësia siguron respektimin e rregullave të BE-së nga organizata. Duke qenë se prokurimet janë një nga fushat me kornizë rregullatore më të madhe në sektorin publik, prokurimet e kryera nga DHSK-ja dhe ZPS-ja janë rregullisht objekt kontrollesh dhe auditimesh të rrepta.

Në vitin 2023, NJP-ja vazhdoi punën për të ndërgjegjësuar dhe informuar më tej ofruesit e ardhshëm të mallrave dhe shërbimeve për proceset dhe kriteret e tenderimit, si dhe për t'u ofruar sa më shumë kompanive, pavarësisht vendndodhjes, mundësinë për të punuar me DHSK-në dhe ZPS-në.

Njësia vazhdoi evidentimin e mundësive për të rritur efikasitetin e shpenzimeve dhe për të bërë prokurime sa më cilësore, përfshirë një numër në rritje të kontratave kornizë shumëvjeçare. Gjatë vitit 2023, për DHSK-në dhe ZPS-në u lidhën 103 kontrata të reja prokurimi për mallra dhe shërbime me vlerë 15 milion euro.

Kjo njësi ndihmoi me administrimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe me organizimin e trajnimeve të rregullta për punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së për të siguruar që administrimi i kontratave dhe proceset e anketimit të tregut të kryhen në mënyrë të qëndrueshme dhe rigorozë. Me përpjekjet e saj, Njësia e Prokurimit siguron pajtueshmërinë në tërësi të DHSK-së dhe ZPS-së me praktikatat e mira në fushën e prokurimit dhe minimizimin e rrezikut të mospajtueshmërisë me rregullat dhe rregulloret përkatëse të prokurimit. Dokumenti kryesor ku mbështeten veprimtaritë e prokurimit të DHSK-së dhe ZPS-së është Udhëzuesi Praktik mbi Procedurat e Kontratave për Shërbimin e Jashtëm të BE-së.



Në vitin 2023, për DHSK-në dhe ZPS-në u lidhën 103 kontrata prokurimi për një sërë mallrash dhe shërbimesh, me një vlerë prej 15 milion euro.

# ZYRA E AUDITIMIT

# 6

## Zyra e Auditimit

Auditimi i Brendshëm kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve dhe raportimit të konstatimeve dhe rekomandimeve Administratores.

Gjatë çdo detyre auditimi, audituesja e brendshme vlerëson efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të brendshme. Audituesja e brendshme verifikon statusin e zbatimit të rekomandimeve të saj në auditimet vijuese që kryen. Në punën e saj, audituesja u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe Rregullores Financiare të BE-së, dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.

Gjatë vitit 2023, audituesja e brendshme kreu shtatë auditime në bazë të planit vjetor të auditimit, duke u përqendruar te shpenzimet e llogarive të pagesave, tarifat dhe kostot e rastësishme të ekspertëve, kontributet në fondin e pensionit, shpenzimet në lidhje me shërbimet e paraburgimit, qiraja dhe mirëmbajtja e mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe te subvencionit i akorduar nga qeveria zvicerane.

Audituesja e brendshme kreu pesë auditime vijuese për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të saj. Përveç detyrave të auditimit, audituesja e brendshme u angazhua edhe me trajnime kundër mashtrimit për punonjësit e Gjykatës.

Gjatë çdo detyre auditimi të brendshëm, audituesja e brendshme bën vlerësimin e përputhjes me kuadrin ligjor administrativ të DHSK-së, përfshirë Rregulloren Financiare të BE-së, rregullat e prokurimit, kontratat, procedurat standarde operative dhe udhëzues të tjerë të brendshëm.



# INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS

# 1

## Nxitja e një mjedisi pune mbështetës dhe gjithëpërfshirës në DHSK dhe ZPS

Drejtuesit e lartë të DHSK-së dhe ZPS-së vazhduan të kultivojnë një mjedis pune të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Gjatë gjithë vitit janë marrë masa konkrete për të përforcuar më tej Strategjinë kundër Ngacmimeve dhe Udhëzuesin kundër Ngacmimit të DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe për mbështetjen e mirëqenies së punonjësve. Kanë vazhduar gjithashtu aktivitetet e integritit të perspektivës gjinore.

### Tolerancë zero ndaj çdo forme ngacmimi

Angazhimi i Kryetares së Gjykatës, Administratores dhe Prokurores së Specializuar për marrjen e të gjitha masave për parandalimin dhe adresimin e ngacmimeve në vendin e punës, dhe nxitja e kulturës së dinjitetit dhe respektit reciprok reflektohet në Strategjinë kundër Ngacmimeve të DHSK-së dhe ZPS-së.

Për më tepër, Udhëzuesi kundër Ngacmimit, i miratuar nga Administratorja pas konsultimeve me Kryetaren e Gjykatës dhe Prokuroren e Specializuar, me Organin Përfaqësues të Punonjësve dhe personin e kontaktit për çështje gjinore, synon të sigurojë që në DHSK dhe ZPS të gjithë punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët të kuptojnë rolet, të drejtat dhe përgjegjësitë për mbajtjen e mjedisit të punës pa ngacmime psikologjike dhe seksuale. Udhëzuesi rregullon gjithashtu procesin jozyrtar të zgjidhjes së problemeve në lidhje me sjellje të caktuara, duke plotësuar procesin ekzistues zyrtar të zgjidhjes dhe atë disiplinor. Ai parashih edhe krijimin e strukturave mbështetëse shtesë dhe të pavarura, të cilave mund t'u drejtohen në mënyrë konfidenciale punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët.

### Struktura mbështetëse të përmirësuar

Në përputhje me Udhëzuesin, Administratorja në vitin 2023 prokuroi për DHSK-në dhe ZPS-në shërbimet e një këshilltari me përvojë për mirëqenien, për të udhëzuar dhe ndihmuar punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët në adresimin e pretendimeve për ngacmim nëpërmjet alternativave të disponueshme për zgjidhje zyrtare dhe jozyrtare. Administratorja gjithashtu caktoi një ndërmjetësues të jashtëm që të luajë rolin e palës së tretë të pavarur gjatë proceseve të zgjidhjes jozyrtare, dhe për të ndihmuar palët në gjetjen e zgjidhjeve miqësore.

Që nga krijimi i organizatave, punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së kanë pasur qasje në shërbimet e psikologes. Në vitin 2023, roli i psikologes u rrit në përputhje me Udhëzuesin kundër Ngacmimit dhe detyrimin e përgjithshëm të organizatës për përkujdesje. U bënë përpjekje paraprake për të ritheksuar mundësitë e punonjësve për të përdorur këto shërbime, nëpërmjet takimeve në njësi të ndryshme dhe atyre individuale për të sqaruar rolin e saj dhe mundësitë për të mbështetur punonjësit.

Si pjesë e qëllimit të përgjithshëm për të siguruar që punonjësit të jenë në dijeni të mënyrave të shumta të disponueshme të mbështetjes, Organi Përfaqësues i Punonjësve dhe personi i kontaktit për çështje gjinore i DHSK-së dhe ZPS-së luajnë një rol të rëndësishëm duke informuar punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët për strukturat ekzistuese të mbështetjes dhe duke ndihmuar, sipas nevojës, në identifikimin e strukturave shtesë.

## Trajnimet e posaçme

Trajnime të specializuara për parandalimin e ngacmimit psikologjik dhe seksual, si pjesë e Strategjisë kundër Ngacmimit, u janë ofruar punonjësve çdo vit që nga viti 2021 dhe vazhduan t'u ofrohen punonjësve të rinj në vitin 2023.

Për t'u siguruar që Udhëzuesi kundër Ngacmimit është kuptuar në tërësi, u organizuan gjatë gjithë vitit shtatë sesione trajnimi shtesë mbi elementet e reja të Udhëzuesit, duke dhënë informacion të hollësishëm mbi strukturat mbështetëse në dispozicion. Deri në fund të vitit, u trajnuan 95% e punonjësve.

Gjithashtu, u ofruan edhe trajnime të specializuara ndërvepruese për drejtuesit e nivelit të parë dhe të dytë, Organin Përfaqësues të Punonjësve dhe personin e kontaktit për çështjet gjinore të DHSK-së dhe ZPS-së mbi trajtimin e pretendimeve për ngacmim në një atmosferë mbështetëse. Deri në fund të vitit 2023, trajnimin e ndoqën 80% e drejtuesve të nivelit të parë dhe të mesëm, dhe u planifikuan sesione shtesë për të siguruar pjesëmarrje 100% brenda janarit 2024.



Trajnime mbi Udhëzuesin kundër Ngacmimit, tetor 2023

## Veprimtari të brendshme ndërgjegjësuere

Në bazë të parimit se parandalimi i çdo forme ngacmimi është përgjegjësi e përbashkët e të gjithë organizatës, Administratorja konceptoi një plan të brendshëm veprimtarish ndërgjegjësuere dhe komunikuese, nëpërmjet të cilit u krijuan infografikë dhe pllakate për punonjësit ku jepet një pasqyrë e dobishme e kuadrit për parandalim, raportim dhe reagim ndaj incidenteve të ngacmimit në DHSK dhe ZPS. Ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit në DHSK bashkërendoi përgatitjen e materialeve të posaçme informuese duke theksuar përgjegjësinë e përbashkët për të parandaluar ngacmimet dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi kanalet ekzistuese dhe procedurat e raportimit të sigurt të këtyre rasteve.

Në vitin 2023 u krijua edhe një faqe e dedikuar në intranet. Ajo shërben si një vend ku mblidhet i gjithë informacioni për parandalimin e ngacmimit në vendin e punës dhe në lidhje me punën. Faqja ka gjithashtu materiale trajnuese dhe një pasqyrë të strukturave mbështetëse në dispozicion, përfshirë informacionin se si të kërkohen takime me këshilluesin për Mirëqenien të DHSK-së dhe ZPS-së dhe me psikologjen, si dhe informacionin përkatës mbi Ndërmjetësuesin e Jashtëm.





Prezantimi i Udhëzuesit kundër Ngacimit

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ka raportuar shpesh tek Administratorja mbi zbatimin e Udhëzuesit kundër Ngacimit. Në të ardhmen, këto raporte të rregullta do të përfshijnë të dhëna statistikore anonime nga këshilluesi për Mirëqenien i DHSK-së dhe ZPS-së,

drejtuesit e linjës dhe ndërmjetësuesit e jashtëm për numrin e rasteve të ngacimeve të pretenduara të trajtuara nëpërmjet proceseve jozyrtare, dhe mbi suksesin apo jo të këtyre rasteve.

## Mjedisi mbështetës pune

Krahas përpjekjeve të lartpërmendura, personi i kontaktit për çështjet gjinore dhe NJBNJ-ja, në nxitje të një mjedisi mbështetës pune, ku siguria dhe mirëqenia psikologjike janë kyç, kanë organizuar trajnime në kuadër të programit 'Diversitet, Gjithëpërfshirje, dhe Barazi' me tema si "Krijimi i një Mjedisi Pune Psikologjikisht të Sigurt" dhe "Kultivimi e Sigurisë Psikologjike," ky i dyti posaçërisht për drejtues të nivelit të parë.

Në vitin 2023, NJBNJ-ja nisi fazën e parë të programit për mirëqenien, që synon përkujdesjen ndaj shëndetit mendor, forcimin e qëndrueshmërisë dhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme të punonjësve, praktikantëve dhe kontraktuesve. Në dhjetor 2023, u zhvilluan dy takime në kohën e pushimit të dregës me temat "Kultivimi i Qëndrueshmërisë: Strategji për Përmirësimin e Shëndetit Mendor" dhe "Si të Mundësh Trishtimin e Dimrit: Teknika për një Stinë më të Ndrirshme".


Programi i mirëqenies do të vazhdojë edhe në vitin 2024, për nxitjen e një mjedisi pune mbështetës për shëndetin mendor/fizik dhe mirëqenien e personave që punojnë në DHSK dhe ZPS. Programi thekson më tej rolin e drejtuesve në mbështetje të punonjësve dhe në forcimin e strukturave mbështetëse në dispozicion të punonjësve. Faqja në intranet dedikuar mirëqenies është rifreskuar, duke u përqendruar në forcimin e njohurive, aftësive dhe sjelljes së punonjësve, dhe në ofrimin e teknikave ushqyese dhe të kujdesit ndaj vetes.

Gjatë vitit 2023, kanë qenë në dispozicion të punonjësve edhe shërbimet e mjekut të DHSK-së, përfshirë këshillat ergonomike për shprehi më të shëndetshme pune.

# Përfaqësimi gjinor në DHSK dhe ZPS

31 dhjetor 2023

Meshkuj 53%



Femra 47%

## Integrimi i perspektivës gjinore

Që nga fillimi, drejtuesit e DHSK-së dhe ZPS-së kanë nxitur aktivitetet për integrimin e perspektivës gjinore për një përfaqësim më të balancuar gjinor. Këto përpjekje janë përqendruar në arritjen dhe mbajtjen e përfaqësimit të barabartë gjinor në të gjitha nivelet e organizatës dhe rritjen e përfaqësimit të grave në fusha ku numri i tyre është tradicionalisht më i vogël.

Me emërimin e znj. Kimbërli Uest si Prokurore e Specializuar në vitin 2023, DHSK-ja dhe ZPS-ja janë aktualisht e vetmja Gjykatë e këtij lloji me tri drejtuese femra.

Përfaqësimi i grave në mesin e punonjësve të rinj të DHSK-së dhe ZPS-së është rritur vazhdimisht nga vetëm 29% më 2018 te një barazi e plotë në vitin 2020, dhe 56% në vitet 2021 dhe 2022. Në vitin 2023, 43% e punonjësve të rinj në DHSK-së dhe ZPS-së ishin femra. Megjithëse përqindja u ul në krahasim me vitin 2022, një numër punonjësesh të reja iu bashkuan njësive të DHSK-së në fusha ku numri i tyre është tradicionalisht më i vogël, si në Njësinë e Paraburgimit dhe Njësinë e Teknologjisë së Informacionit. Për vitin 2023, nga punonjësit e rinj në ZPS, 48% ishin femra.

Nga numri i gjithsejtë i punonjësve në DHSK dhe ZPS më 31 dhjetor 2023, 47% ishin femra dhe 53% meshkuj. Ky raport gjinor ishte i njëjtë me atë të arritur në fund të vitit 2022.

Në fund të vitit 2023, raporti i përgjithshëm gjinor mes punonjësve të DHSK-së ishte 52% meshkuj dhe 48% femra. Femrat përbënin 54 për qind të punonjësve në nivel ekspertësh dhe drejtimi, ndërsa meshkujt 46%.


ZPS-ja arriti përfaqësim të barabartë në nivel sekretari dhe asistenti në vitin 2022, dhe e ruajti këtë raport në vitin 2023. Raporti në nivel ekspertësh dhe drejtuesish vazhdoi prirjen pozitive të viteve të mëparshme, me 58% meshkuj dhe 42% femra. Për vitin 2022, në nivel ekspertësh dhe drejtuesish, ky raport ishte 60% meshkuj dhe 40% femra. Përqindja e femrave në numrin e përgjithshëm të punonjësve në ZPS u rrit në dy vitet e fundit nga 38% në vitin 2021 në 40% në vitin 2022 dhe në vitin 2023 arriti në 44%.

Gjatë vitit 2023, NJBNJ-ja vazhdoi të mbledhë dhe analizojë rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi përfaqësimin gjinor dhe rishikoi progresin e arritur në arritjen dhe mbajtjen e përfaqësimit të barabartë gjinor në të gjithë nivelet e organizatës. Theksi vazhdoi të vihet në integrimin e perspektivës gjinore në trajnimet orientuese për punonjësit e rekrutuar rishtas, si dhe në trajnimet për të gjithë anëtarët e paneleve të rekrutimit të punonjësve gjatë vitit.

Punonjësit patën gjithashtu mundësinë të merrnin pjesë në trajnime, të ofruara nga NJBNJ-ja, që synonin përmirësimin e aftësive (ndër)personale, përfshirë "Aftësitë Drejtuese dhe Trajnimi Situativ", "Menaxhimi i Konfliktëve" dhe "Drejtimi i Ekipeve me Efektshmëri të Lartë".



**NIVEL DREJTUESI DHE  
EKSPERTI (DHSK)**




MESHKUJ



FEMRA

**NIVEL DREJTUESI DHE  
EKSPERTI (ZPS)**




MESHKUJ



FEMRA

**NIVEL SEKRETARI  
DHE ASISTENTI (DHSK)**



MESHKUJ



FEMRA

**NIVEL SEKRETARI  
DHE ASISTENTI (ZPS)**



MESHKUJ



FEMRA

## 2

# Personi i kontaktit për çështjet gjinore

Prania e personit të kontaktit për çështjet gjinore është shprehje e përkushtimit të përgjithshëm të drejtuesve të lartë për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një mjedisi pune gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2023, personi i kontaktit për çështje gjinore organizoi një sërë aktivitete, mes të cilave edhe festimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Tema e vitit 2023 për Ditën Ndërkombëtare të Gruas ishte "Pranoje Barazinë" dhe punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së u mbledhën për të festuar dhe nderuar punonjëset e organizatës, ku Kryetarja, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar dhe anëtarja e njërit prej ekipeve të Mbrojtjes, si dhe personi i kontaktit për çështje gjinore, folën për Ditën Ndërkombëtare të Gruas.

*Kemi arritur përfaqësim të barabartë gjinor, gjë që është mbështetje e fuqishme për angazhimin e Drejtuesve për të hapur dyert, për të dhënë mundësi dhe për të besuar në aftësitë tona si për të pasur sukses ashtu dhe për t'iu gëzuar suksesit të kolegeve tona. Nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së rregullt të të dhënave të ndara, në sajë të përpjekjeve të palodhshme të paneleve të rekrutimit të punonjësve, në sajë të trajnimeve dhe rritjes së ndërgjegjësimit, DHSK-ja arriti përfaqësim të barabartë gjinor në nivel ekspertësh dhe drejtuesish, dhe në përgjithësi për të gjithë personelin.*

Personi i kontaktit për çështjet gjinore në Ditën Ndërkombëtare të Gruas më 8 mars 2023

INTERNATIONAL  
**WOMEN'S**  
DAY



Personi i kontaktit për çështje gjinore, me ndihmë administrative nga Njësia e Burimeve Njerëzore, organizoi edhe një program gjashtëjavor intensiv trajnimi për zhvillimin e aftësive drejtuese për 13 gra të DHSK-së dhe ZPS-së me titullin "Ja ku po vjen ajo!" Programi u mundësoi pjesëmarrëseve të reflektonin për stilet e preferuara të drejtimit, ofruan trajnime konkrete për t'u bërë më të dukshme brenda DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe teknika të tjera drejtimi gjithëpërfshirës dhe transparent në ekipet e tyre përkatëse.

Një pjesë e grave që ndoqën atë program trajnimi më pas vunë në zbatim një sërë ndryshimesh në ekipet e tyre për të rritur efektivitetin dhe gjithëpërfshirjen në përgjithësi.

Në qershor 2023, personi i kontaktit për çështje gjinore ndoqi takimin vjetor të këshilltarëve të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Gjinore të misioneve të Bashkimit Evropian për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të organizuar nga Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm. Gjatë tri ditëve u bënë prezantime me temë në lidhje me, ndër të tjera, këshilluesit për çështjet gjinore në misionet e ndryshme, si dhe u ofruan seminare për integrimin e perspektivës gjinore.

DHSK-ja dhe ZPS-ja gjithashtu ishin mikpritëse e një aktiviteti të organizuar nga Rrjeti i Grave në të Drejtën Ndërkombëtare (Rrjeti i GLN-së) në ambientet e gjykatës më 31 tetor 2023, duke shpallur një program mentorimi të nivelit të lartë. Ky program mentorimi, i njohur si Mentoring4Future (mentorim për të ardhmen), nisi fillimisht nga Ambasadorja e Republikës së Austrisë, Sh.s. Astrid Hark, bashkë me Rrjetin e GLN-së. Ky ishte aktiviteti i parë i zhvilluar në mjediset e Gjykatës nga të tri Drejtueset e larta, bashkë me Prokuroren e Specializuar të emëruar rishtas. Kryetarja Ekaterina Trendafilova, e cila ishte mentore e këtij programi vitin e kaluar, u uroi të ftuarve mirëseardhje në ambientet e Gjykatës.



Drejtueset e larta të DHSK-së dhe ZPS-së, mikpritëse të aktivitetit Rrjeti i Grave në të Drejtën Ndërkombëtare, tetor 2023

Personi i kontaktit për çështjet gjinore, anëtare e bordit të Rrjetit të GLN-së, paraqiti programin e mentorimit në emër të bordit. Këtë vit, Administratorja Fidelma Donlon, Prokurorja e Specializuar Kimbërlit Uest dhe gjykatëse Mapi Feld-Folia do të jenë ndër mentoret e shquara të programit.

Personi i kontaktit për çështje gjinore administron gjithashtu faqen e dedikuar në intranet, e cila përditësohet rregullisht me artikuj interesantë dhe lidhje në internet për aktivitete që kanë të bëjnë përgjithësisht me integrimin e perspektivës gjinore, gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.

*Dua të falënderoj gjithashtu drejtueset e larta të Gjykatës sonë, Kryetaren Trendafilova, Administratoren Dr. Fidelma Donlon, dhe Prokuroren e Specializuar Kimbërlit Uest, si mikpritëse të aktivitetit. Nuk më ka shpëtuar fakti që ndodhem para një Gjykate ku të tri drejtueset e larta janë femra. Edhe vetëm ky fakt jep një mesazh të fuqishëm dhe dëshmon se sa larg kemi arritur.*

*Jam gjithashtu krenare të jem këtu si person i kontaktit për çështjet gjinore të një Gjykate ku të tri drejtueset e larta ose kanë marrë pjesë, ose do të marrin pjesë si mentore në raundin e ardhshëm, bashkë me njërin prej gjykatëseve tona, gjykatësen Mapi Veld-Folia, e cila gjithashtu do të jetë mentore.*

Personi i kontaktit për çështje gjinore, 31 tetor 2023



Personi i kontaktit për çështjet gjinore në aktivitetin e Rrjetit të GLN-së, 31 tetor 2023



# ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

# Parathënie

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), së bashku me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), shënoi një sërë arritjesh vitin e kaluar. Ajo hapi dy gjykime; debatoi apelimet në dy gjykime të tjera në të cilat ishte dhënë verdikti; dhe arrestoi katër persona për vepra kundër administrimit të drejtësisë. Gjatë kësaj, ajo vazhdoi të sigurojë që DHSK-ja të shërbejë si një forum i drejtësisë, duke siguruar një proces të rregullt gjyqësor për të akuzuarit dhe një mjedis të sigurt ku dëshmitarët mund të flasin hapur për ato që kanë dëshmuar apo përjetuar, pa pasur frikën se do të jenë objekt i frikësimit apo hakmarrjes. Kjo, nga ana e saj, ndihmon në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.



Kimbërli Uest, Prokurore e Specializuar

ZPS-ja është në gjendje të kryejë procedime penale në sajë të guximit të shumë burrave dhe grave, të cilët kanë bashkëpunuar me hetimet tona dhe i besuan institucionit tonë. Prandaj, ZPS-ja e merr jashtëzakonisht seriozisht frikësimin e dëshmitarëve, hakmarrjen ndaj dëshmitarëve dhe pengimin e drejtësisë, dhe do të vazhdojë të hetojë dhe ndjekë penalisht në çdo hap secilin dhe të gjithë ata që janë përfshirë në vepra të tilla, apo që frikësojnë ose ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve, apo mbështesin financiarisht apo me mënyra të tjera vepra penale të tilla.

Unë u bëra Prokurore e Specializuar në tetor, dhe u jam mirënjohëse dy paraardhësve të mi, dhe veçanërisht, ish-Prokurorit të Specializuar Xhek Smith, për arritjet e shumta që e kanë sjellë ZPS-në aty ku është sot. I jam mirënjohëse gjithashtu z. Aleks Uajting, i cili shërbeu si Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar nga nëntori 2022 deri në gusht 2023, dhe zëvendësit tim, Vard Ferdinandse, dhe prokurores së lartë Kler Loson, për udhëheqjen e përkohshme të ZPS-së gjatë muajve para ardhjes sime. Unë synoj të çoj më tej punën e paraardhësve të mi dhe të çoj përpara të gjithë aspektet e punës së ZPS-së sa më shpejt që është e mundshme.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndër të cilët edhe shtetin pritës, Holandën, si dhe Norvegjinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara si shtete kontribuuese të treta, që vazhduan të ofrojnë burimet dhe mbështetjen e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit që kanë bërë të mundur kryerjen e punës sonë. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj punonjësit e ZPS-së, të tanishëm dhe të mëparshëm, si dhe punonjësit e DHSK-së, në veçanti Kryetaren Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, për mikpritjen dhe angazhimin e përkushtimin e jashtëzakonshëm ndaj institucionit.

**Kimbërli Uest**  
Prokurore e Specializuar

*Hagë, dhjetor 2023*



# Hetimet e ZPS-së

ZPS-ja u themelua më 1 shtator 2016 mbi bazën e një ndryshimi kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. DHSK-ja dhe ZPS-ja u krijuan pas hetimit të kryer më parë nga Task Force Hetimore Speciale (TFHS) dhe ZPS-ja trashëgoi punonjësit dhe mandatin e TFHS-së.

TFHS-ja ishte krijuar për të hetuar dhe, nëse do të ishte nevoja, të ndiqte penalisht individë për krimet e pretenduara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të janarit 2011 "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë". TFHS-ja ishte një subjekt i pavarur, juridiksioni dhe autoriteti ligjor i së cilës buronte nga Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian për themelimin e EULEX-it.

Hetimet e TFHS-së u drejtuan nga Klinton Uilliamson (Clinton Williamson), prokuror nga Shtetet e Bashkuara dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës. Në korrik 2014, ambasadori Klinton Uilliamson sugjeroi që për hetime të mëtejshme duhej të krijohet një gjykatë.

ZPS-ja është institucion i pavarur, pavarësia e së cilës garantohet nga Ligji që e krijoi atë. Në këtë mënyrë, ZPS-ja ka detyrimin të veprojë në mënyrë të pavarur prej Dhomave të Specializuara dhe prej të gjithë prokurorëve të tjerë në Kosovë.

Ligji gjithashtu urdhëron Prokurorin e Specializuar dhe personelin e ZPS-së që të mos kërkojnë e as të marrin udhëzime nga ndonjë qeveri apo burim tjetër.

Në juridiksionin e saj, DHSK-ja ka përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. DHSK-ja ose ZPS-ja mund të urdhërojnë transferimin e procedurave që përfshihen në juridiksionin e tyre nga çdo prokuror apo gjykatë tjetër në territorin e Kosovës të Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja, në cilëndo fazë të hetimeve apo të procesit gjyqësor.

Prokurori i Specializuar është i autorizuar të marrë në pyetje viktimat, dëshmitarët dhe të dyshuarit dhe të regjistrojë deklaratat e tyre, të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura dhe të kryejë veprimtari të tjera hetimore të nevojshme; të kërkojë ndihmën e shteteve të treta dhe organizatave ndërkombëtare apo subjekteve të tjera; dhe të marrë masa hetimore sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

Dejvid Shvendiman shërbeu si Prokuror i Specializuar nga shtatori 2016 deri në mars 2018, pasi kishte qenë më parë kryeprokuror i TFHS-së që prej qershorit 2015. Xhek Smith pasoi z. Shvendiman në postin e Prokurorit të Specializuar në maj 2018 dhe shërbeu në atë post deri në nëntor 2022. Kimbërlit Uest pasoi z. Smith në pozicionin e Prokurorit të Specializuar në tetor 2023.



Dejvid Shvendiman, Prokuror i Specializuar 2016-2018



Xhek Smith, Prokuror i Specializuar 2018-2022

# Zbatimi i mandatit

ZPS-ja vazhdoi të përparojë me shpejtësi në vitin 2023. Ajo hapi dy gjykime, debatoi apelimet në dy çështje, dhe arrestoi katër persona për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Gjithashtu, ZPS-ja vazhdoi të nxjerrë prova për ekipet e Mbrojtjes.

Gjithashtu, Kimbërli Uest, e cila ka qenë më parë prokurore federale e SHBA-së me përvojë të gjerë si në hetimet për krime në nivel vendor dhe ndërkombëtar, zëvendësoi Prokurorin e Specializuar Xhek Smith si Prokurore e Specializuar. Ajo u emërua më 2 qershor 2023 pas një procesi të organizuar nga Bashkimi Evropian dhe filloi detyrën më 18 tetor 2023. Aleks Uajting shërbeu si Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar nga nëntori 2022 në gusht 2023.


## Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

ZPS-a filloi çështjen gjyqësore kundër ish-presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit më 3 prill 2023, dhe deri në fund të vitit, Trupi Gjyqësor pranoi dëshmi nga 71 dëshmitarë, përfshirë dëshmi të drejtpërdrejta nga 39 dëshmitarë.

Në deklaratën e tij hyrëse, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting tha: “Kjo është një çështje që ka lidhje me sundimin e ligjit në kohë lufte. Askush, as në kohë lufte, nuk është mbi ligjin.”

Z. Uajting theksoi gjithashtu se ky proces gjyqësor nuk ngarkonte me përgjegjësi penale Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe nuk ishte akuzë kundër të gjithëve në UÇK. “Pjesa dërrmuese e anëtarëve të UÇK-së nuk kishin asnjë lidhje me këtë çështje apo me krimet për të cilat është ngritur aktakuza,” vazhdoi z. Uajting. “Kjo është një çështje vetëm për gjërat që bënë këta katër burra, për krimet që kryen gjatë luftës, për përgjegjësinë që u takon sipas ligjit.”

Kundër zotërinjve Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë ngritur gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë të personave – dhe katër akuza për krime lufte – arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.



Në rreshtin e parë: Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting, Zëvendësprokurori i Specializuar Vard Ferdinandse dhe prokurori i lartë Alan Tiger  
Në rreshtin e dytë: prokurori Mat Holling, prokurorja e lartë Kler Loson dhe prokurori Xhejms Paç

## Reagimi i Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar ndaj Aktgjykimit të Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj

Pas aktgjykimit në apelin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting dha një deklaratë ku bëri të qartë se Zyra e Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë të ndjekë penalisht të gjitha rastet e frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrjes ndaj dëshmitarëve dhe pengimit të drejtësisë.

“Unë e mirëpres aktgjykimin e sotëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara që përforcon sundimin e ligjit në Kosovë dhe i dërgon një mesazh të qartë kujtdo që përfshihet në frikësimin e dëshmitarëve, hakmarrjen ndaj dëshmitarëve dhe pengimin e drejtësisë,” tha Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

“ZPS-ja i merr këto krime jashtëzakonisht seriozisht dhe do të vazhdojë të hetojë dhe ndjekë penalisht këdo dhe të gjithë ata që përfshihen në këtë akt në çdo rast,” vazhdoi z. Uajting.

“Kjo çështje gjyqësore lidhet me kushtet që kërkohen për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe atë që nevojitet për ta bërë sundimin e ligjit realitet. Dëshmitarët duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë pa pasur frikë nga hakmarrja dhe ndëshkimi.”



Sipas aktakuzës, këto krime u kryen më e pakta prej marsit 1998 deri në shtator 1999 në disa vendndodhje në Kosovë, si dhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipëri. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Në aktakuzë pretendohet se zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi kanë përgjegjësi penale individuale për krime që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dhe DHSK-ja i transferoi në objektin e paraburgimit në Hagë më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja e dorëzoi dosjen e saj paraprake dhe versionin e përditësuar të saj më 24 shkurt 2022. ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më tej më 30 shtator 2022 dhe gjatë vitit 2023 bëri 416 parashtrime.

## Reagimi i Prokurores së Specializuar ndaj Aktgjykimit të Apelit në Çështjen Mustafa

Pas aktgjykimit në apelin e Salih Mustafës, Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest tha në një deklaratë se vendimi i apelit përfaqëson "fitore për drejtësinë."

"Mirëpres aktgjykimin e sotëm i cili, me gjithë ndryshimin e vogël të dënimit të Z. Mustafa, përbën një fitore për drejtësinë dhe, në veçanti, për viktimat e Salih Mustafës dhe familjet e tyre," tha znj. Uest.

Prokurorja e Specializuar lavdëroi gjithashtu guximin e dëshmitarëve që dhanë dëshmi në gjyqin kundër Mustafës. "Gatishmëria e dëshmitarëve për të dëshmuar ishte kritike në këtë çështje gjyqësore dhe unë përshëndes guximin e tyre në dhënien e dëshmimeve në sallën e gjyqit," tha ajo.



### Prokurori kundër Pjetër Shalës

ZPS-ja hapi çështjen e Pjetër Shalës më 21 shkurt 2023 dhe përfundoi paraqitjen e provave më 6 korrik 2023, kohë gjatë së cilës dhjetë dëshmitarë dëshmuuan në sallë të gjyqit. Paraqitja e provave nga Mbrojtja filloi më 20 shtator 2023 dhe ende vazhdon në fund të vitit 2023.

Pjetër Shala përballet me katër akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë, dhe vrasje e paligjshme – të kryera përafërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri.

Në deklaratën e tij hyrëse, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Uajting theksoi se çështjet gjyqësore në Dhomat e Specializuara, përfshirë çështjen Shala, nuk janë akuza kundër Kosovës apo UÇK-së, por ndaj individëve që pretendohet se gjatë luftës kanë kryer krime, ku shumica e viktimave ishin shqiptarë të Kosovës.

"Kjo Gjykatë afirmon parimin e sundimit të ligjit në Kosovë, përfshirë të drejtën e personave të akuzuar për krime lufte për të pasur një gjykim të drejtë, dhe thekson se askush nuk është mbi ligjin dhe se ata që akuzohen për kryerjen e krimeve ndërkombëtare duhet të merren në përgjegjësi, pavarësisht nga kauza për të cilën luftojnë," tha z. Uajting.

Z. Shala u arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 15 prill 2021. Ai pati paraqitjen e parë më 19 prill 2021. ZPS-ja dorëzoi dosjen e saj paraprake më 28 janar 2022 dhe një version publik të redaktuar të saj më 14 prill 2023. Në vitin 2023, ZPS-a bëri 151 parashtrime.

### Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

ZPS-ja debatoi apelin dhe kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në çështjen gjyqësore kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, të shpallur fajtorë më 18 maj 2022 për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe ishin dënuar me burgim katër vjet e gjysmë dhe me gjobë 100 euro secili.

Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit la në fuqi vendimet e fajësisë të shkallës së parë për z. Gucati dhe z. Haradinaj. Gjithashtu, ai mbajti në fuqi pjesën më të madhe të konstatimeve të Trupit Gjykues dhe prapësoi një konstatim, duke ulur për pasojë dënimin nga katër vjet e gjysmë në katër vjet e tre muaj burgim.

---

Më 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme të DHSK-së hodhi poshtë kërkesat e z. Gucati dhe z. Haradinaj për mbrojtje të ligjshmërisë. Në vitin 2023, ZPS-ja dorëzoi për këtë çështje 14 parashtrime.

### **Prokurori kundër Salih Mustafës**

ZPS-ja debatoi gjithashtu dhe një apelim të Salih Mustafës për shpalljen e tij fajtor, më 16 dhjetor 2022, për ndalim të paligjshëm, torturë dhe vrasje, dhe për dënimin e tij me 26 vjet burg.

Në aktgjykimin e 14 dhjetorit 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi të gjitha vendimet për fajësinë e z. Mustafa, duke theksuar natyrën e rëndë të krimeve, dhe modifikoi dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burg.

ZPS-ja mori pjesë në seancën e apelit më 26 dhe 27 tetor dhe bëri 30 parashtrime për këtë çështje gjyqësore gjatë vitit 2023.

### **Arrestimet e Ismet Bahtijarit dhe Sabit Januzit**

ZPS-ja arrestoi Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin më 5 tetor 2023 në Kosovë, në bazë të një fletarrestimi, aktakuzës së konfirmuar dhe urdhrit për transferim të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i DHSK-së. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe u paraqitën para Gjykatësit të Procedurës Paraprake më 9 tetor 2023.

Aktakuza i akuzon z. Januzi dhe z. Bahtjari për frikësim dhe tentim përmes kërcënimit të rëndë për të penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, individualisht si dhe përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët si grup. Në këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja dorëzoi 91 parashtrime gjatë vitit 2023.



Rreshti i parë, nga e majta: prokurorët Sezari Mihalçuk dhe Niko Barlink  
Rreshti i dytë: Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest

## Takimet informuese diplomatike



Gjatë vitit 2023, ZPS-ja mori pjesë në një varg takimesh informuese diplomatike për t'u dhënë shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese informacion të përditësuar mbi punën e ZPS-së, sfidat me të cilat përballëj, dhe mënyrat se si mund të ndihmonte komuniteti ndërkombëtar që ZPS-ja të përshpejtonte punën e saj.

Në dhjetor 2023, në Hagë, Prokurorja e Specializuar Kimbërlë Uest, së bashku me Kryetaren e DHSK-së Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, iu drejtuan diplomatëve nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese.

Në shtator 2023, Zëvendësprokurori i Specializuar Vard Ferdinandse, së bashku me Kryetaren Trendafilova dhe Administratoren Donlon, folën para Palës së Punës për Ballkanin Perëndimor (COWEB) të BE-së. Në janar 2023, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting, së bashku me Kryetaren Trendafilova dhe Administratoren Donlon, informuan ambasadorët e Komitetit Politik dhe të Sigurisë (KPS) të Bashkimit Evropian.

## Arrestimi i Isni Kilajt

ZPS-ja arrestoi Isni Kilajn në Kosovë më 2 nëntor 2023 në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Prokurori i Specializuar. Një ditë më vonë, z. Kilaj u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë dhe më 4 nëntor 2023 u paraqit para Gjykatës të Vetëm.

Z. Kilaj u arrestua për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkeljen e sekretit të procedurës. Në këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja dorëzoi 18 parashtrime gjatë vitit 2023.

## Arrestimi i Haxhi Shalës

ZPS-ja arrestoi Haxhi Shalën më 11 dhjetor 2023 në bazë të një fletarrestimi dhe urdhri për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

Ai u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë më 12 dhjetor 2023 dhe më 13 dhjetor 2023 u paraqit para Gjykatës të Procedurës Paraprake.

Z. Shala u arrestua për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë frikësimin e dëshmitarëve. Në këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja dorëzoi 14 parashtrime gjatë vitit 2023.

Pas arrestimit të z. Shala, Prokurorja e Specializuar Kimbërlë Uest tha: "Është shumë e rëndësishme që të garantohet që qytetarët e Kosovës të flasin për përvojat duke treguar të vërtetën dhe pa u ngacmuar, jo vetëm për aftësinë e këtij institucioni të japë drejtësi por edhe për sundimin e ligjit në Kosovë. ZPS-ja do të vazhdojë të bëjë çdo gjë brenda fuqive të saj për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët dhe për të vënë para përgjegjësisë ata që shkelin ligjet e Kosovës për interesat e tyre private."

## Procedura e ekstradimit të Dritan Goxhaj

ZPS-ja kërkoi gjithashtu arrestimin dhe ekstradimin e një shtetasi shqiptar, Dritan Goxhaj, në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë frikësim dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Më 31 korrik 2023, pas fletarrestimit të kërkuar nga ZPS-ja dhe të lëshuar nga një gjykatës i DHSK-së, autoritetet shqiptare arrestuan z. Dritan Goxhaj në Tiranë dhe një gjykatë në Tiranë miratoi ekstradimin e tij më 18 shtator. Megjithatë, z. Goxhaj e apeloj vendimin dhe u lirua nga Gjykata e Apelit më 10 tetor 2023.

Gjithashtu, ZPS-ja vazhdoi gjatë gjithë vitit 2023 marrjen në pyetje të dëshmitarëve; shqyrtimin e të gjitha provave dokumentare të mbledhura gjatë hetimeve dhe përgatitjen e tyre për nxjerrje; dhe punoi me autoritetet përkatëse të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve për të marrë miratimin për përdorimin e tyre në Gjykatë dhe miratimin për dhënien e dëshmive nga dëshmitarët në gjyq.



Prokurorja Taznin Shahabudin



Në rreshtin e parë nga e majta: prokurorët Filipo de Miniçis, Gaja Pergalo dhe Eva Uajler  
Në rreshtin e dytë: Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting

# Kuadri udhëheqës i Prokurorisë

ZPS-ja drejtohet nga një ekip prokurorësh të lartë, që të gjithë me shumë përvojë në juridiksionet e shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare. Prokurorja e Specializuar është Kimbërlia Uest (Kimberly West), e cila ka qenë më parë prokurore federale e SHBA-së me përvojë të gjerë në fushën e hetimeve penale në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar.



**Kimbërlia Uest** | Prokurore e Specializuar

Znj. Uest iu bashkua ZPS-së në tetor 2023 nga Firma Ligjore Eshkroft (Ashcroft Law Firm) në Boston, Masaçusets (Massachusetts), ku ishte partnere që nga viti 2019 dhe ku u përqendrua kryesisht në mbrojtje të çështjeve penale të lidhura me krimin ekonomik. Para se të merrte detyrën në këtë firmë, znj. Uest punoi si prokurore për më shumë se dy dekada në role në nivel lokal, shtetëror, federal dhe ndërkombëtar.

Znj. Uest ka qenë gjithashtu shefe e Byrosë së Krimeve në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Masaçusetsit në periudhën nga viti 2015 deri në 2019. Në këtë rol, ajo mbikëqyri një ekip prej 120 profesionistësh të ngarkuar me hetimin dhe ndjekjen penale të një game të gjerë veprash penale në fushën e mashtrimeve financiare, korrupsionit publik, trafikut të drogës, lojërave të fatit dhe trafikimit të qenieve njerëzore; në mbrojtjen e vendimeve të fajësisë në apel; dhe në ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët.

Znj. Uest mori detyrën në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm pas punës në Zyrën e Prokurorit të SHBA-së, Distrikti i Masaçusetsit, ku shërbeu për dy vjet si ndihmësprokurore federale në Njësinë për Mashtrimet në Kujdesin Shëndetësor dhe gjashtë vjet në Njësinë e Sigurisë Kombëtare.

Për pesë vjet, në periudhën nga viti 2008 deri në 2013, znj. Uest shërbeu si prokurore në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë, ku ishte anëtare e ekipit që ndoqi penalisht Radovan Karaxhiqin për rolin e tij në gjenocidin në Srebrenicë. Ajo ishte gjithashtu në ekipin e prokurorëve në çështjen gjyqësore Përliq dhe të tjerë, që u përqendrua në krimet e kryera në Mostar dhe shkatërrimin e Urës së Vjetër.

Znj. Uest ka gradën Juris Doctor (Doktor në Drejtësi) nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Safolkut (Suffolk), Masaçusets, dhe u bë anëtare e Dhomës së Avokatëve në Masaçusets. Ajo ka gjithashtu diplomë në fushën e arteve nga Kolegji i Bostonit, Masaçusets.



## Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting

Aleks Uajting (Alex Whiting) shërbeu si Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar nga nëntori 2022 deri në gusht 2023, dhe më parë ka qenë Zëvendësprokuror i Specializuar nga shtatori 2020 deri në nëntor 2022, dhe shef i Njesisë së Hetimeve nga qershori 2019 deri në gusht 2020.

Z. Uajting është prokuror me shtetësi franceze dhe amerikane, me përvojë të gjerë pune në fushën e ndjekjeve penale, si në juridiksione të brendshme, ashtu edhe në ato ndërkombëtare, ku përfshihen periudha pune në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe në TPNJ (Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë).

Z. Uajting, i diplomuar në Kolegjin e Jeilit (Yale) dhe Fakultetin e Drejtësisë të Jeilit, erdhi në ZPS nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Harvardit, ku kishte punuar si profesor i praktikës juridike që prej vitit 2013.

Z. Uajting punoi në Zyrën e Prokurorit të GJPN-së nga viti 2010 deri në vitin 2013, fillimisht si koordinator i hetimeve, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve, dhe më pas si koordinator i procedimeve, përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha procedimeve penale.

Në TPNJ, ku punoi nga viti 2002 deri në vitin 2007, z. Uajting ishte kryeprokuror në gjykimin e Fatmir Limajt, Isak Musliut dhe Haradin Balës, dhe kryeprokuror në gjykimet e Millan Martiqit dhe Dragomir Millosheviqit.

Përpara se të punonte në TPNJ, z. Uajting ishte prokuror federal në SHBA, fillimisht në Seksionin Penal të Departamentit të të Drejtave Civile në Uashington dhe më pas në Zyrën e Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Boston, Masaçusets, ku u përqendrua në çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.



Vard Ferdinandse | Zëvendësprokuror i Specializuar

Ushtrues i Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar është Vard Ferdinandse (Ward Ferdinandusse), i cili u bashkua ZPS-së në vitin 2020 si shef i Njesisë së Hetimeve. Z. Ferdinandse, me shtetësi holandeze, përfundoi studimet universitare në drejtësi dhe mbrojtje doktoraturën në Universitetin e Amsterdamit në fushën e zbatimit të së drejtës penale ndërkombëtare në gjykatat kombëtare. Ai ka botuar një numër të madh shkrimesh mbi aspekte kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtës penale. Gjithashtu, ai ishte lektor i së drejtës penale ndërkombëtare dhe evropiane në Universitetin e Groningenit, me fokus mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjatë punës si prokuror në Zyrën e Prokurorisë Publike në Roterдам, z. Ferdinandse u angazhua në procedime penale, procedura ekstradimi dhe hetime të krimeve ndërkombëtare si gjenocidi, krimet e luftës, tortura, pirateria dhe terrorizmi. Para se t'i bashkohej ZPS-së, ai ishte kryeprokuror në gjykimin e çështjes lidhur me rëzimin e avionit MH17.



Alan Tiger | Prokuror i lartë

Alan Tiger është prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë në SHBA dhe në TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në çështjen e Dushko Tadiqit –, edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në çështjen e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Biljana Pllavshiqit.

Nga viti 1987 deri në vitin 1994, z. Tiger ishte prokuror federal në Seksionin Penal të Drejtorisë së të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut (Rodney King).

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoraturës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin e Santa Klarës.



Kler Loson | Prokurore e lartë

Kler Loson, me shtetësi irlandeze, u diplomua në Kolegjin e Universitetit të Dublinit. Gjatë kohës së studimeve ajo kreu një vit specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin e magjistratit të drejtësisë nga Universiteti i Kolumbias. Përpara se të fillonte punën në ZPS, znj. Loson punoi si juriste në Seksionin Gjyqësor të GJPN-së, në Zyrën e Prokurorisë së TPNJ-së, si këshilltare për të drejtat e njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë të njohur avokatie në Irlandë.

Znj. Loson ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, ndër të cilat, çështje që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian, dhe ish-Jugosllavinë. Ajo gjithashtu ka udhëhequr negociata për të drejtat e njeriut në emër të BE-së në OKB.

# Ekipe e Prokurorisë

## Ekipi i Prokurorisë në apelin e Mustafës

Në vitin 2022, ekipi i Prokurorisë në apelin e Salih Mustafës përbëhej nga Cezari Mihalçuk (Cezary Michalczuk) dhe Niko Barlink (Nico Baarlink). Z. Mihalçuk është prokuror polak, i arsimuar në Poloni dhe në Britaninë e Madhe, i cili, ndër të tjera, ka punuar si shef i Seksionit Juridik dhe Sundimit të Ligjit në zyrën e Përfaqësueses së Posaçme të BE-së në Kosovë në vitet 2015-2020, ndërsa në periudhën 2010-2015 ishte shef i Njësisë së Krimeve të Luftës në Prokurorinë

Speciale të Republikës së Kosovës. Z. Barlink është ndihmësprokuror gjerman, i cili ka kryer arsimimin the trajnimin ligjor në Australi. Ai ka punuar më parë në Zyrën e Prokurorive Publike në Melburn, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias dhe në Dhomën Gjyqësore të Tribunalit Special për Libanin.



Cezari Mihalçuk | Prokuror



Niko Barlink | Ndihmësprokuror

## Ekipi i Prokurorisë në apelin e Gucatit dhe Haradinajt

Në vitin 2022, ekipi i Prokurorisë në apelin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt përbëhej nga Xhejms Paç dhe Met Holling. Z. Paç është prokuror maltez, i arsimuar në Maltë dhe Britaninë e Madhe, i cili më parë ka punuar në zyrën e prokurorisë në Gjykatën e

Posaçme të Sierra Leones dhe në GJPN. Z. Holling është prokuror amerikan i miratuar për ushtrimin e profesionit të avokatit në gjykatat e Kalifornisë, i cili iu bashkua ekipit të ZPS-së në vitin 2020 nga GJPN-ja, ku kishte punuar që prej vitit 2011.



Xhejms Paç | Prokuror



Met Holling | Prokuror

## Ekipi i Prokurorisë në Gjykimin e Shalës

Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Pjetër Shalës përbëhet nga Filipo De Miniçis, Gaja Pergolo dhe Eva Uajllër. Z. De Miniçis është ndihmësprokuror italian që më parë ka punuar në TPNJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Korenë e Jugut. Znj. Pergolo është ndihmësprokurore italiane, e arsimuar në Itali dhe Britaninë e Madhe, e cila më parë ka punuar në Zyrën e Prokurorit të Mekanizmit Përmbyllës Ndërkombëtar të Tribunalëve Penalë në

Hagë; në kuadër të programit të ndihmës teknike të Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Pnom Pen, Kamboxhia; dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen. Ajo gjithashtu ka punuar për REDRESS, një organizatë joqeveritare që kryen procedime penale në emër të të mbijetuarve të torturës. Znj. Uajllër është ndihmësprokurore zvicerane, e cila më parë ka punuar si avokate në një nga firmat kryesore të avokatisë në fushën e padive penale, hetimit dhe së drejtës penale në Zvicër, dhe si gjykatëse hetuese ushtarake dhe prokurore ushtarake.



**Filipo De Miniçis**  
ndihmësprokuror



**Gaja Pergolo**  
ndihmësprokurore



**Eva Uajllër**  
ndihmësprokurore

### Personeli

Personeli i ZPS-së përbëhet nga prokurorë, këshilltarë juridikë, specialistë të sigurisë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe personel mbështetës. Në fund të vitit 2023, personeli i ZPS-së përbëhet nga 78 punonjës me 24 shtetësi të ndryshme nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese. Nga këta 78 punonjës, 44 ishin meshkuj dhe 34 femra.







DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS  
RAPORTI I VITIT 2023**

Botuar dhe shpërndarë nga:  
Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë:  
Shqipe, serbishte dhe anglishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së:  
[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)

Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:  
[mediaKSC@scp-ks.org](mailto:mediaKSC@scp-ks.org)

Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:  
[spokespersonSPO@scp-ks.org](mailto:spokespersonSPO@scp-ks.org)

Paraqitja grafike:  
Wim Jansen Design  
[www.wimjansendesign.nl](http://www.wimjansendesign.nl)

Shtypur nga:  
Quantes Grafimedia  
[www.quant.es.nl](http://www.quant.es.nl)

E drejta e autorit © 2024 Dhomat e Specializuara dhe  
Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Të gjitha të drejtat të rezervuara.



A blue-tinted photograph of a wooden chair and a glass gavel on a table. The chair is in the background, and the gavel is in the foreground, resting on a white surface. The entire image has a monochromatic blue color scheme.

[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)